# Tregime pas / Tregime nëpër Koleksionin e Galerisë Kombëtare të Kosovës

Tregime pas / Tregime nëpër Koleksionin e Galerisë Kombëtare të Kosovës





# Tregime pas / Tregime nëpër Koleksionin e Galerisë Kombëtare të Kosovës

Tregime pas / Tregime nëpër Koleksionin e Galerisë Kombëtare të Kosovës



«GRAFIKA E KRIJUESVE KOSOVARË» NË LONDËR

## NJË PREZENTIM I SUKSESSHËM

- U ekspozuan 50 punime të 15 autorëve dhe, pos Londrës, ekspozita do të hapet edhe në Glasgou e Belfast

## U HAP EKSPOZITA E ARTISTËVE FIGURATIVË TË KOSOVËS

## RRJEDHAT E REVOLUCIONIT – RRJEDHA TË ARTIT

ËSHTË MËKAT QË VEPRAT E KOSOVA RËVE NUK PREZENTOHEN NË EVROPË

Ibrahim Kodra mbi veprat e artistëve figurativ të Kosovës

ME RASTIN E EKSPOZITËS VJETORE TË KRIJUESVE FIGURATIVË TË PRISHTINËS

SPEKTËR I GJERË INTERESIMESH

TAKIME

I DASHURUAR NË BUKURITË E TREVAVE TË VENDLINDJES

■ Nga biseda me piktorin akademik, Nimon Lokaj, profesor i Gjimnazit „Vëllezërit Frashëri" në Deçan

# Tregime pas / Tregime nëpër

# Koleksionin e

# Galerisë Kombëtare të Kosovës

Përmbajtja


5 Hyrje

9 Arkivistja nën hije:
Intervistë me Lirije Buliqin

15 Rritja e Koleksionit ndër vite:
Intervistë me Naim Spahiun

19 Hyrije Krypa

45 Anton Gllasniqi

- 55 Intervistë me Mehmet Behlulin
- 67 Intervistë me Faik Krasniqin

71 Hilmija Ćatović

- 79 Siç e kujton i biri

111 Nimon Lokaj

139 Violeta Xhaferi

- 143 Udhëtim artistik nëpër kohë

158 Kolofoni



# KOSOVA ME GALERI TË ARTEVE

Vargut të institucioneve kulturore-arsimore të Krahinës së Kosovës, këto ditë i shtohet edhe një institucion i ri – galeria e arteve në Prishtinë, ku do të kultivohen dhe shprehen rrjedhat e krijimtarisë bashkëkohore të artit figurativ dhe aplikativ, si dhe të dizajnit industrial.

Sipas kumtesës së Sekretariatit Krahinor të Informatave, Komisioni i themelimit të galerisë së arteve të Kosovës, nën drejtimin e Pajazit Nushit, kryetar aprovoi dje Statutin e galerisë së arteve të Prishtinës dhe miratoi Marrëveshjen për shfrytëzimin e lokaleve të posaçme në kompleksin e objektit «Boro dhe Ramizi» për nevojat e galerisë.

Në këtë institucion, sipas të gjitha gjasave, do të organizohen mbrëmje debatike për zhvillimin e artit, ligjërata, projeksione filmike e manifestime të tjera.

M.M.



Galeria Kombëtare e Kosovës si institucioni kryesor kulturor i arteve pamore në Kosovë sot përmban mbi 1100 vepra arti në koleksionin e saj. Këto vepra filluan të mblidhen gradualisht pas hapjes së këtij institucioni në vitin 1979.

Hulumtimi ynë filloi duke analizuar veprat e koleksionit, duke shikuar vëmendshëm artistët dhe punët e tyre, vitet kur janë mbledhur dhe në çfarë rrethana ka ndodhur kjo. Më pas fokusi ynë u përqendrua në pesë nga artistët, veprat e të cilëve janë pronë e Koleksionit të Galerisë Kombëtare sot: Anton Gllasniqi, Nimon Lokaj, Hilmija Ćatović, Hyrije Krypa, dhe Violeta Xhaferi.

Fokusi në këta pesë artistë nuk është krejtësisht i rastësishëm. Pos idesë që të hulumtojmë rreth disa artistëve më pak të njohur, të pesë artistët posedojnë elemente të tjera të përbashkëta. Artistë që kanë prodhuar në një seri të mediumeve të ndryshme: prej pikturës në grafikë, e instalacione me tekstil, gati të gjithë artistët e paraqitur në këtë publikim kanë vijuar studimet në qytete të ish-Jugosllavisë, në mungesë të Fakultetit të tillë në Kosovë dhe të gjithë ishin aktiv përafërsisht në vitet 1970 dhe 1980. Rrjedhimisht punët e tyre janë ekspozuar në Sallone, ndodhi e ekspozita kolektive të kohës, e me pak në periudhën e pas luftës.

Hulumtimi ynë është fokusuar në materiale arkivore si katalogje të ekspozitave, gazeta, revista e libra te ndryshme që gjenden në arkivin e Galerisë Kombëtare të Kosovës dhe në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Përkundër qëllimit për të hapur GKK-në për hulumtuesit e jashtëm, për shkak të mungesës së rregulloreve dhe hapësirave të përshtatshme Arkivi dhe Koleksioni vazhdojnë të jenë fizikisht të mbyllur për ta. Me rastin e këtij hulumtimi, qasja në dokumente të Galerisë është ndërmjetësuar nga stafi i Galerisë dhe veprat janë fotografuar nga fotografi zyrtar i Galerisë. Galeria është aktualisht duke punuar për të krijuar një sistem të brendshëm që do t'ia mundësonte hulumtuesve qasjen në këto dy resurse të pasura që dokumentojnë artin e Kosovës.

Për më shumë, kemi intervistuar dy nga artistët, por edhe familjarët, bashkëpunëtorët, njohësit e punës së këtyre artistëve dhe kritikët e artit.

Ju ftojmë të zhyteni me ne në punën dhe jetën e këtyre artistëve duke lexuar zinën tonë në të cilen përfshihen fotografitë e veprave të këtyre artistëve që gjenden në koleksion, intervista, e materiale të tjera arkivore që kemi hasë përgjatë hulumtimit tonë një vjeçar.

Rina Krasniqi



## Arkivistja nën hije:
## Intervistë me Lirije Buliqin

Lirije Buliqi, skulptore dhe artiste që punon me qeramikë, ka punuar në Galerinë Kombëtare të Kosovës për më shumë se katër dekada. Gjatë kësaj periudhe, Buliqi shërbeu si "arkiviste nën hije" e Galerisë, duke dokumentuar zhvillimet në dhe përreth Galerisë.

Çfarë kanë qenë kriteret në bazë të cilave janë zgjedhur veprat për koleksionin e Galerisë Kombëtare të Kosovës gjatë viteve? A ka dallime nga gjenerata në gjeneratë?

Në vitin 1984 është përpiluar Rregullorja për kriteret e blerjes së veprave artistike nga artet figurative dhe aplikative. Kjo rregullore ka caktuar kriteret në bazë të cilave është realizuar dhe blerja e veprave për Koleksion.

Vlen të theksohet se kjo rregullore e vendosur nga Galeria e Arteve në vitin 1984, është trashëguar nga Rregullorja e Bashkësisë Krahinore për Kulturë për blerje të veprave artistike për Galerinë e Arteve në vitet e më hershme ku në komision ishin: Engjëll Berisha, Blerim Luzha, Hamdi Miftari, Osman Osmani.

Sipas dokumenteve nga Arkivi, një Rregullore daton në vitin 1978 ku po atë vit u blenë gjithsej 50 vepra dhe iu dorëzuan Engjëll Berishës, i cili ishte Bashkëpunëtor Profesional në Galerinë e Arteve.

Po ashtu janë dorëzuar edhe disa vepra të cilat janë trashëguar apo dhuruar nga atëherë Qendra Krahinore për Kulturë dhe nga Komiteti Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë.

Çmimi më i lartë për një vepër arti është bazuar në medium ku piktura ka pasur çmimin më te lartin ndërsa më te ultin e kanë caktuar për grafikë, seriografi do të thotë për veprat të cilat reprodukohen.

Nga viti 1979 e tutje Galeria ka blerë vepra nga artistët kur janë organizuar ekspozitat sipas programit

të caktuar nga Pleqësia e Galerisë së Arteve me propozim, dhe Bashkësia Krahinore për Kulturë, në kuadër të bashkëpunimit ndër-republikan [në ish-Jugosllavi] dhe propozimit të drejtorit të Galerisë. Do të thotë, kur është organizuar një ekspozitë në Galeri sipas programit vjetor atëherë edhe iu është blerë ndonjë vepër artistit. Përveç kësaj, fondi i veprave është pasuruar edhe duke vizituar atelietë e artistëve nga anëtarët e Pleqësisë së Galerisë nëpër vende të ndryshme të Kosovës dhe nga ekspozitat e ndryshme nëpër republikat e ish-Jugosllavisë.

Po ashtu, një numër i konsiderueshëm i artistëve kanë dhuruar veprat e tyre për koleksion. Vlen të theksohet se Ibrahim Kodra ka dhuruar (deklarata 10 korrik 1980) 20 vepra në vitin 1980. Po ashtu edhe shumë artistë si: Omer Kaleshi, Gjelosh Gjokaj dhe shumë emra të njohur të artistëve të shquar.

Gjithashtu koleksioni pas viteve te 80-ta është pasuruar edhe me vepra të dhuruara nga artistë të njohur ndërkombëtar e sidomos theks te veçantë duhet t'i vihet dhurimit të Mapës me 16 grafika nga Edo Murtiq dhe 2 pllakata qe ishin pjese përbërëse e Muzeut XIV te Lojërave Dimërore Olimpike Sarajevo 84 (nr.protok.01-62 te vitit 1985); si dhe shumë vepra të artistëve të tjerë nga rajoni dhe Evropa. Nga Art Qendra e Zagrebit është dhuruar qeramika e artistit te njohur Hanibal Salvaro, Grafika Sllovene.

Në vitin 1988 u blenë edhe 50 grafika nga 15 grafistë kosovarë te cilët do të prezantonin grafikën kosovare në Gjermani. Kështu ka vazhduar blerja e veprave sipas ekspozitave. Këto do të mund të specifikoheshin ndoshta me ndonjë rast tjetër, pra numri i veprave të blera çdo vjet.

Në këtë periudhë artistë të cilët dhuruan komplet ekspozitën, si Ymer Shaqiri i cili e pasuroi koleksionin me vizatimet dhe grafikat e tij.

Po ashtu ne vitin 2010 janë dhuruar gjithsej 43 vepra nga 24 artistë vendor dhe nderkombëtar ( nr. te protokolit 03 nr. 140).



A ka ndryshuar mënyra se si janë koleksionuar veprat gjatë viteve? Çfarë mund të ndani prej përvojës suaj gjate viteve që keni punuar ne Galerinë Kombëtare të Kosovës se si është bërë ky proces?

Mënyra nuk ka ndryshuar edhe shumë, në mënyrë të njëjtë është pasuruar koleksioni duke u bazuar ne Rregulloren e vitit 1984 e cila u përdor deri 1990. Gjatë kësaj periudhe, konkretisht në vitin 1998, sipas Listës së regjistrimit Galeria ka numruar gjithsej 723 vepra arti nga gjithsej 232 artista vendor dhe nderkombëtar nga të cilat jane blerë, dhuruar, dhe trashëguar nga Qendra Krahinore e Kulturës, Komiteti Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. (Në Elaborat çdo vepër është e specifikuar, mënyra e pasurimit te Fondit).

Gjatë viteve te 90-ta për shkak të rrethanave socio-politike shumë pak është pasuruar Fondi.
Pas luftës mënyra e përzgjedhjes së veprave për blerje gjithmonë është bërë duke e caktuar një komision profesional i cili ka bërë përzgjedhjen e veprave për blerje. Është hera e parë këto dy vitet e fundit [2022-2023] që për pasurimin e Fondit të Galerisë Kombëtare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është bërë thirrje publike për artistë që të konkurrojnë me veprat e tyre për shitje.

Nga cila periudhë kohore (dekadë) mendoni se koleksioni i GKK-së është pasuruar më së shumti dhe me vepra të cilat më së shumti kanë vlerë kombëtare dhe artistike për të qenë pjesë e koleksionit të artit të shtetit të Kosovës?

Në disa dokumente te arkivit të vitit 1979, për shembull, fjala hyrëse për hapjen e Galerisë së Arteve nga z. Pajazit Nushi, Nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës thuhet se koleksioni i galerisë ka filluar te pasurohet qysh para 20 vjetëve. Në vitin 1949 u hap Shkolla e Mesme e Arteve në Pejë; në vitin 1962 grupi i Arteve Figurative në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë; në vitin 1972, Akademia e Arteve Figurative në Prishtinë. Arsimimi gjithnjë e më intenziv i gjeneratave të reja hapi procesin e ndryshimit të pikëpamjeve, shkallës së vlerësimit

të veprave artistike, e kështu me radhë. Filluan të formohen pikëpamje të reja mbi artin e krijimtarisë figurative.

Koleksioni i Galerisë më së shumti është pasuruar ne vitet e '80-ta. Me rastin e hapjeve të çdo ekspozite personale apo kolektive, vendore apo ndërkombëtare, jane blerë apo janë dhuruar vepra nga artistë të ndryshëm. Veprat në fjalë janë të regjistruara në fletoren e Procesverbaleve të cilat gjinden në Arkivin e Galerisë. Po ashtu çdo fundvit është bërë regjistrimi i veprave (Elaborati i veprave dhe librave profesionale), e që po ashtu gjinden në arkivin e GKK. Sigurisht se kanë pas vlerë artistike sipas Komisionit vlerësues profesional. Mendoj që vlera e tyre është shumë më e madhe sot pasi qe këto vepra shënojnë një histori kulturore të Galerisë Kombëtare dhe vendit ku mijëra artistë kanë marrë pjesë në këto ekspozita që u vizituan nga qindra mijëra dashamirë të artit tonë.

Galeria e Arteve e Kosovës ka prezentuar artistët kosovarë në shumë ekspozita ndërkombëtare si në: Paris, Tokio, Bombaj, Augsburg (Gjermani), Berno (Republika Çeke), Tiranë, Shkup etj.

Sipas regjistrimit të fundit, Galeria e Arteve e Kosovës posedon më shumë se 1000 vepra artistike të profileve të ndryshme.

Artistikisht, çfarë i mungon Koleksionit të GKK? Për shembull, sipas hulumtimit tonë del që në Koleksion gjenden shumë pak vepra të artisteve gra. A mendoni se duhet të jetë koleksion më gjithëpërfshirës dhe nëse po, si do të mund të arrihet një gjë e tillë?

Mungesa e artisteve gra është e vërtetë qe vërehet në koleksion. Mendoj se kjo vjen edhe si pasojë e numrit të vogël të grave si artiste aktive gjate kohërave sa është pasuruar koleksioni. Sigurisht që koleksioni duhet të jetë gjithëpërfshirës, mendoj se iniciativat e reja për të pasuruar fondin shtetëror mund ta plotësojnë këtë mungesë duke vizituar studiot e artisteve që më nuk jetojnë, gra, apo familjarëve qe trashëgojnë veprat e tyre dhe kështu ta plotësojnë fondin me këto mungesa.



Gjatë viteve të '90-ta, veprat e artistëve shqiptarë nuk janë koleksionuar. Sipas jush, a mendoni se kjo mungesë duhet adresuar nga organet qendrore dhe të mblidhen/ruhen vepra nga kjo periudhë?

Po do të ishte shumë me interes që te plotësohet Fondi i Galerisë edhe me vepra të cilat nuk mund te bliheshin gjatë viteve të '90-ta.

Sipas jush, si është gjendja e veprave të Koleksionit të Galerisë Kombëtare sot, dhe çfarë mendoni se duhet të ndërmerret në nivele qendrore në lidhje me këtë Koleksion?

Gjendja është relativisht e mirë, ky koleksion ruhet në kushtet "ato qe janë" në Galeri, një hapësirë e duhur për ruajtjen, konservimin dhe restaurimin e veprave te koleksionit të GKK-së. Sipas regjistrimit te vitit 2014 nga gjithsejt 897 vepra artistike (si : 350 piktura; 361 grafika; 71 skulptura; 32 pllakate; 33 fotografi; 3 tapiseri; 5 video ; 42 vizatime); janë evidentuar afro 74 vepra te cilat pak a shumë janë të dëmtuara. Andaj mendoj se duhet te jetë urgjencë kombëtare.

A mendoni se Qeveria duhet të blejë vepra të artit për Koleksionin e GKK vazhdimisht dhe përkundër faktit që nuk ka hapësirë të posaçme, dhe nuk janë kushtet adekuate për mirëmbajtjen e tyre? Më tej, nuk ka një hapësirë ekspozuese vetëm për Koleksion, veprat e të cilit herë pas here do të mund të ishin të ekspozuara dhe të qasshme për publikun?

Blerja e veprave mendoj se duhet të vendosen nga institucionet përkatëse siç është në këtë rast GKK duke u bazuar në kushtet, nevojat dhe vizionin e vet si institucion arti.

Koleksioni shpaloset kohë mbas kohe pjesërisht për publikun, por kishte me qenë më se e drejtë që të kishte ekspozitë permanente të koleksionit të GKK.

Çfarë do të ishte një mënyrë alternative që qeveria dhe GKK të mbështesin artistët deri në një kohë ku do të jenë kushtet e plotësuara me standarde ndërkombëtare për zgjerimin e Koleksionit?

> Blerja e veprave duhet të konsiderohet si vlerë dhe pasurim i Koleksionit. Indirekt është ndihmë financiare apo financim i punës së mëtejshme për artistin. Është një shtytje dhe stimulim për vazhdimin e krijimtarisë artistike e cila do të ishte shembull për nxitje dhe afirmim të krijimtarisë si fond me peshë dhe veçanti individuale dhe kolektive. Njëherit inspirim i gjeneratave të ardhshme dhe kujtesë e ndjenjave të së kaluares dhe rrjedhjes së mëtejme.



## Rritja e Koleksionit ndër vite: Intervistë me Naim Spahiun

Naim Spahiu, artist bashkëkohor i cili një kohë ishte Zëvendësdrejtor i Galerisë Kombëtarë të Kosovës, sot shërben si Kordinator për Ekspozita në po të njëjtin institucion.

Çfarë kanë qenë kriteret në bazë të cilave janë zgjedhur veprat për koleksionin e Galerisë Kombëtare të Kosovës gjatë viteve? A ka dallime nga gjenerata në gjeneratë?

> Galeria ka krijuar fonde për blerjen e veprave dhe në këtë mënyrë është pasuar Koleksioni që nga themelimi. Kurse në vitet e pas-luftës, me sa e di unë, nuk ka pasur asnjëherë mjete të mjaftueshme për blerjen dhe pasurimin e koleksionit, dhe kështu është hapë një mundësi e pasurimit të Koleksionit përmes dhurimit të veprave nga vet artistët.

A ka ndryshuar mënyra se si janë koleksionuar veprat gjatë viteve? Çfarë mund të ndani prej përvojës suaj gjate viteve që keni punuar ne Galerinë Kombëtare të Kosovës se si është bërë ky proces?

> Gjatë këtyre viteve në GKK, mënyra e seleksionimit, apo koleksionimit, të veprave ka ndryshuar nga viti në vit, varësisht nga menaxhimi i drejtorëve.
> Gjatë periudhës 2004–2009, është një numër i vogël i artistëve që i jane blerë veprat, kurse pjesa tjetër është dhuruar nga vet artistët në kordinim me Drejtorin. Pastaj deri në vitin 2022, nuk ka pasë blerje por vetëm dhurime të veprave, që si rezultat kanë qenë ekspozitat personale dhe kolektive të artistëve në planprogramin e GKK-së.

Nga cila periudhë kohore (dekadë) mendoni se koleksioni i GKK-së është pasuruar më së shumti dhe me vepra të cilat më se shumti kanë vlerë kombëtare dhe artistike për të qenë pjesë e koleksionit të artit të shtetit të Kosovës?

Pasurimi i Koleksionit në GKK, gjatë viteve 1970 deri në fund të viteve të '80-ta është përfaqësimi më i dinjitetshëm i artistëve, dhe sipas mendimit tim, janë pionierët, apo themeluesit, e artit kosovar, siç janë Nysret Salihamixhiqi, Muslim Mulliqi, Agim Çavdarbasha, Engjëll Berisha, Gjelosh Gjokaj, dhe koleksionimi i grafikave nga Olimpiada e Sarajevës e vitit 1984, me artistë të njohur botëror siç janë: Andy Warhol, Henry Moore, e të tjerë.

Artistikisht, çfarë i mungon Koleksionit të GKK? Për shembull, sipas hulumtimit tonë del që në Koleksion gjenden shumë pak vepra të artisteve gra. A mendoni se duhet të jetë koleksion më gjithëpërfshirës dhe nëse po, si do të mund të arrihet një gjë e tillë?

Është e vërtetë sepse deri në vitet e para luftës, ka qenë një numër i vogël [i artisteve gra], pastaj në vitet në vazhdim është rritur por jo mjaftueshëm. Si vazhdimësi unë mendoj që menaxhmenti i GKK-së në planin afatgjatë [duhet] të pasurojë koleksionin me një përfaqësim më të dinjitetshëm nga femrat krijuese.

Sipas jush, si është gjendja e vepravë të Koleksionit të Galerisë Kombëtare sot, dhe çfarë mendoni se duhet të ndërmerret në nivele qendrore në lidhje me këtë Koleksion?

Koleksioni i GKK-së nuk është në gjendje dhe në kushte optimale, por trajtohet me mjaft kujdes nga stafi i Galerisë. Por urgjentisht duhet të bëhet një plan për trajtimin dhe ruajtjen e Koleksionit kur e kemi parasysh gjendjen e një numri të madh të veprave që duhet të restaurohen dhe konzervohen.

A mendoni se Qeveria duhet të blejë vepra të artit për Koleksionin e GKK vazhdimisht dhe përkundër faktit që nuk ka hapësirë të posaçme, dhe nuk janë kushtet adekuate për mirëmbajtjen e tyre? Më tej, nuk ka një hapësirë ekspozuese vetëm për Koleksion, veprat e të cilit herë pas here do të mund të ishin të ekspozuara dhe të qasshme për publikun?



Unë mendoj se Qeveria duhet të koncentrohet më shumë në blerjen e veprave për Koleksionin e Muzeut të Artit Bashkëkohor të Kosovës, kurse koleksionimi i veprave për GKK-në të bëhet sipas politikave afatgjata dhe profesionale të GKK-së. GKK duhet të ketë një hapësirë ekspozuese permanente vetëm për Koleksionin e saj.

Çfarë do të ishte një mënyrë alternative që qeveria dhe GKK të mbështesin artistët deri në një kohë ku do të jenë kushtet e plotësuara me standarde ndërkombëtare për zgjerimin e Koleksionit?

Ne kemi artistë shumë të mirë që dinjitetshëm na prezantojnë në arenën ndërkombëtare, që bartin vlera kudo. Prandaj fillimisht duhet të punohet në krijimin e hapësirave të duhura se ku do të ruhen dhe trajtohen mirë, e pastaj të kenë kujdes në krijimet e komisioneve që bëjnë vlerësimin dhe blerjen e tyre, sepse sipas mendimit tim, komisionet e dy viteve të fundit nuk kanë bërë përzgjedhje të dinjitetshme që vërtetë prezantojne vlerat e artit kosovar.

# Hyrije Krypa





«GRAFIKA E KRIJUESVE KOSOVARË» NË LONDËR

# NJË PREZENTIM I SUKSESSHËM

**● U ekspozuan 50 punime të 15 autorëve dhe, pos Londrës, ekspozita do të hapet edhe në Glasgou e Belfast**

Galeria e Arteve Figurative e Kosovës, pos prezentimit të vlerave tona në vend, gjithnjë e më shumë po bën përpjekje që ato t'i prezentojë dhe t'i afirmojë edhe në botë. Kështu, gjatë punës së vet pesëvjeçare arriti të tubojë në fondin e vet rreth 500 vepra të autorëve të ndryshëm të Krahinës, të vendit dhe të botës. Nga koleksionet e fondit të saj pa mëdyshje më i pasuri është «Arti bashkëkohor kosovar». Pjesa e këtij koleksioni, e zgjedhur si ekspozitë me të njëjtin titull, tash sa kohë është prezentuar me sukses, pos në qendra të ndryshme të vendit, edhe në Siri, Itali, Turqi, Suedi dhe Danimarkë. Veç kësaj, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, ekspozita «Grafika e krijuesve kosovarë» këto ditë u hap edhe në galerinë e Qendrës së Arteve të Vatermanit në Bretford të Londrës. Publikut anglez me këtë ekspozitë iu prezentuan 50 grafika të 15 autorëve, në mesin e të cilëve edhe të Shaip Çitakut, Hyrie Krypës, Ymer Shaqirit, Tomislav Trifiqit e të Fatmir Zajmit. Me rastin e hapjes së ekspozitës, në Galerinë e Qendrës së Arteve të Vatermenit ishte i pranishëm edhe drejtori i Galerisë së Arteve të Kosovës, Shyqri Nimani. Nga ai mësuam se hapja e ekspozitës ishte solemne, kurse qenë të pranishëm vizitorë të shumtë të strukturave të ndryshme angleze, në



**Për ekspozitën në Londër pati interesim të madh: pamje nga ekspozita**

mesin e të cilëve edhe krijues të arteve figurative, historianë të artit e kritikë të tjerë. Në hapje mori pjesë edhe kryetari i «Visiting Arts Unit» të Britanisë së Madhe, Henri Hughes, si dhe ambasadori i RSFJ në Londër. Sipas përshtypjeve të vizitorëve, ekspozita zgjoi interesim të jashtëzakonshëm dhe ishte befasi për publikun britanik. Një numër i madh vizitorësh shprehu dëshirën për blerjen e punimeve. Nga më të pëlqyerat ishin grafikat e Fatmir Krypës, të Zoran Jovanoviqit, të Hysni Krasniqit dhe të Agim Salihut. Për interesimin e jashtëzakonshëm dëshmon edhe fakti se, pos Londrës, kjo ekspozitë do të prezentohet edhe në Glasgou dhe Belfast. Sa i përket prezentimit në Glasgou, që bëhet në janar 1985, duhet cekur se Galeria ku do të hapet ekspozita është e specializuar për grafikë (Prin's Studio Gallery), ndërsa në Belfast ajo do të hapet në shkurt të vitit të ardhshëm. Ekspozita «Grafika e krijuesve kosovarë» në Galerinë e Londrës do të jetë e hapur deri më 9 dhjetor.

V. NURA

**RILINDJA** **E martë, 20. XI. 1984**

Hyrije Krypa:
Intervistë me artisten

E lindur në vitin 1945 në Pejë, Hyrije Krypa është grafiste. Pasi që e kreu shkollën e mesme të artit në Pejë, Krypa filloi të jepte mësim si arsimtare e artit në shkollë fillore. Në vitin 1974, Hyrija u zhvendos në Prishtinë së bashku me bashkëshortin e saj Fatmir Krypën, grafist dhe ilustrator. Para se të vazhdonte edukimin e saj formal në Akademinë e Arteve Figurative në Prishtinë, ajo tregon se dashuria e saj për grafikën lindi duke i ndihmuar Fatmirit në procesin e tij të krijimit të grafikave. Ndonëse pjesëmarrëse e shumë ekspozitave kolektive të grafistëve të Kosovës që nga vitet e hershme të 1980-ta, veprat e Krypës nuk janë shfaqur ende në ekspozitë personale. Në një bisedë gjysmë të strukturar të zhvilluar në shtëpinë e çiftit në lagjen Marigona në Prishtinë në shkurt 2024, Hyrija Krypa rrëfen për fillet e karrierës së saj dhe vështirësitë e ndryshme që çifti kanë hasur përgjatë karrierës së tyre duke punuar shpeshherë në atelie të vogla.

Prej ekspozitave në të cilat keni marrë pjesë, cilën prej tyre e kishit veçuar?

Ekspozita e cila është mbajtë në Angli [në vitin 1984] ka qenë ma e veçantë, po edhe një në Zvicër.

Në cilin vit ishte ajo ekspozita në Angli?

Fatmiri nashta e din, se kemi marrë pjesë në shumë.

Na për hulumtim e kemi zgjedhë: Hilmija Ćatovićin, Nimon Lokaj, Violeta Xhaferin, Anton Gllasniqin edhe juve. A keni pasë shoqni edhe me Nimon Lokaj?

Po, ishte në gjeneratë me Fatmirin. Këta janë dy gjenerata para meje në shkollën e mesme të artit.

Në Pejë?

Në Pejë, atje ka qenë shkolla e artit, ka qenë edhe një në Novi Sad, një në Ljubljanë. Këto kanë qenë në Jugosllavi. Krejt problemat kur i përjashtojshin nëpër shkollat tjera vijshin në Pejë {qesh}.

Përnime a? {Qesh} Aty e keni kry edhe ju?

Po se une pejone jam. Qaty në mahallë e kisha shkollën. Aty në shkollë kanë qenë Muslim Mulliqi, Blerim Luzha, ata ishin më të mëdhej se unë, ata s'i kom njoftë se une ma e vogël kam qenë. E kanë pasë nji sandëk që i gjujshin ngjyrat, se atëherë shkolla i ka financu ngjyrat. Une e kisha babën në këshill të shkollës, edhe të lagjes. S'kishte shqiptar në këshill, edhe e kan ftu babën tem. U konë ni shqiptar po ka bo ndeshje. Tash na me shoqe shkojshim te ngjyrat, ato tempera, i merrshim cka kanë mbetë për me i përdorë {qesh}.

A jeni njoftu aty me zoti Fatmirin?

Po, që 61 vjet jemi bashkë.

Ti masanej e ke pasë edhe profesor a po?

Po, në akademi. Ky është 3 vjet ma i madh se une, po ka hi në shkollë ma vonë, a çka po di, e na ka ra mu konë vetëm dy gjenerata dallim në shkollë. Po ky para meje, Agim Çavdarbasha e ka pasë në klasë. Unë kam qenë në klasë me Esat Vallën, Halil Muhaxherin, e këta ma të mëdhaj se na. Kur shkojsha unë me këta, shok të mirë e kom pasë Halilin, e me Catin [Esat Vallën] hala.

A po endeni hala me Esat Vallën?

Po nganjiherë, po shumë rrallë. Kanë qenë pesë shqiptarë në klasë: Fatmiri, Agimi, mandej Mustafa Ferizi...

Po ai ka bo shkrime masanej...

Po, mandej Muhamet Shala..



Nimoni?

Po edhe Nimoni, e tjerët ishin serb. Pak kemi qenë. 12 veta në klasë.

E në gjeneratë me ty kush ka qenë?

E në klasë me mu ka qenë: Supie Bojku, Remzije Turjaka, me shkollë të lartë kanë mbetë, Sevdije Sahatçiu ajo bile as shkollën e lartë s'e ka përfundu, ka mbetë me shkollë të mesme. S'ka punu kurrë.

Këto mandej krejt kanë punu në arsim?

Po.

Në Prishtinë kur keni ardhë?

Që 50 vjet, në 1974.

Qatëherë vetëm ke qenë duke punu?

Fatmiri u pranu në Radio Televizionin e Prishtinës, e po thotë "Kuku n'Prishtinë me shku!" Halili u pranu në akademinë e arteve mas gjysmëvjetorit të parë edhe më tha, "A po vjen në vend temin në shkollën ekonomike?" Unë thashë, "Po more." Me shkollë të lartë isha e punojsha në shkollë fillore. Halili më tha: "S'ka lidhje njejtë është." Ata ishin konë nxanësat ma të këqij e drejtoreshë ka qenë ni Radmilla Dermaku edhe tha, "A po hyn meniher në orë?" Une i thashë, "Nuk jom e përgatitun, kam ardhë me u njoftu me nxanësat". Tani erdh me mu, "Qe ditari." Aty e gjeta vëllaun e nji shokut të Fatmirit, edhe nji pejone e gjeta aty.

Qysh tu dok me punu aty?

Une isha e re, 28 vjet, ata pak ma t'vegjël se une, se janë regjistru edhe ma vonë në shkollë. Mirë shumë pata kalu, po kur u hap akademia une shkova aty te drejtori, se u

ndërru se erdh ni serb tjetër. I thashë “Une po du me shku në akademi me studiu.” Tha “Jo ti edhe atje mundesh edhe këtu,” se ka që i mbajnë te dyjat.

Une isha studente e Fatmirit, se une e mësova zanatin pa e regjistru grafikën. Në akademi ish Fatmiri, e kënaqësi ishte.

A të ka pëlqy gjithmonë grafika, apo ke pasë interesim edhe në mediume tjera?

Jo une aty fillova me ndje etjen që më pëlqen, se shkollën e lartë e kom përfundu në degën e arsimit, për arsimtare të artit. Po kur ia nisi Fatmirit tirazhi me iu shtu, ia nisa “Hajt qe une po të ndihmoj, qe une ngjyrën e zezë, qe ngjyrat tjera.” E atëherë e mësova mirë zanatin {qesh}. Para se me regjistru Akademinë, tanë verën më ka shti me ushtru në modele, ma bojke “Që s’je ma e mira nuk mundesh me regjistru,” qështu më thojke {qesh}.

E regjistrova, e kryva mandej, u munduam me punu po nuk kishim atelie, sa kem me qira, e kishim nji kat e dhoma ma e madhe ishte atelieja, bile e merrsha ni reshov, e blejsha se harrojsha gjellën. Se une i kisha tre fëmijë tash, kap merre tenxheren qaty, puno, shyqyr kurrë s’mu ka djegë diçka. Nejse, erdhëm në banesë, s’ka atelie, banesa dy-dhomëshë 61 metra katrorë, nji korridor, une qato grafikat e fundit në kuzhinë i kom bo. Prej akuatintës që më pëlqejke, shkova në linogdhendje.

Akuatinta ka qenë metoda që t’ka pëlqy ma së shumti?

Po, tash linogdhendje ishte ma e thjeshtë. Për mu ma e lehtë se vetem e gdhendë pllakën e linoleumit.

Punimi i *Ganimete Tërbeshit* a është linogdhendje?

Linogdhendje.

E punimi që është me maca në fotele?



Eh qajo është akuatintë. Ato janë me pllakë të zinkut të punume. Kjo është në linoleum. Kjo gdhendet me brisqe.

Une me acid punojsha, duhet me qenë shumë e kujdesshme. Fatmiri e pat marrë ni sandek qe ia ka pasë bo baba, qaty e qitshin thartinën, se une i kisha fëmijtë. Vajza e madhe i kishte shtatë vjet kur kemi ardhë prej Gjakovës, e vogla pesë e gjysmë, a djali, Dreni ka lindë në Prishtinë. Në atë kohë nuk kishte gra shqiptare qe i këqyrshin fëmijtë, ishtë nji grua rome, a din sa mirë i këqyrke? Veç më ka ndihmu, e kryva Akademinë, mandej jam marrë me krijimtari.

Kur e blemë atelienë te Qafa, na ra standardi, trazirat, atelieja i ka shërby për studenta nëntë vjet! Ata kanë punu aty, na e kishim ni tirazh me motive ma tradicionale, se na jetojshim prej qasaj. Kur vijke naj fytyrë publike, Ibrahim Rugova kur vijke, ata dojshin diçka autoktone, merrshin diçka. Edhe vajza prej Zvicrës na çojke letrat, se këtu kurrgja s’kish për me ble. Në Turqi i kanë gjetë, aty pat letra për grafikë, çfarë kualiteti. I kena marrë 50 letra.

Kur jena kthy në banesë masi u kry lufta, Fatmiri e pat bo nji derë në bodrum, qaty i pat çu krejt punimet, aty edhe bombën me lshu su çelke. As nuk e kishin thy banesën. Po ke nji shef i policisë që tha qe duhet me lëshu banesën. Tha Fatmiri unë i marrë grafikat, i thashë: “A je tranu a? Si ta qelin gepekin na bojnë brrrr {imiton zhurmën e të shtënave}.” Krejt i murëm, e kishim ni shpi në Gjakovë, ky babën e ka rrobaqepës. Çantat qysh e kan një karton brenda, ia heki edhe qaty i la diplomat, na e kishim edhe vajzën. Na bile me pasë diçka, megjithëse kur shkon dikund ata e shohin çka din, po ndryshe kur e ki letrën. Fati deshti na u kthymë na në Tetovë, se Fatmiri punonte aty, në akademi, edhe para luftës 10 vjet aty ka punu, merrte rrogë mandej ia jepshin edhe u kthymë e bani ni mbindërtim ai poshtë, tha “Po du,” se na e kemi pasë terasën, e madhe, ai e kish lejen, “A po doni me mbulu se s’kom pare”, neve na vyjke ni atelie, e kishim ato te Qafa po ajo 20 metra katrorë, krejt studentat qaty 9 vjet kanë punu.

E qaty në atelie i kanë majtë ligjeratat a?

Qaty kanë diplomu krejt studentat e Fatmirit, çfarë punime ka ky. I thashë, "Çoi n'galeri," se s'po din ku mi lonë. Kuku sa t'mira. Po ky tani fol për veti.

Sa i përket punimeve tuaja, plot prej tyre kanë figura të kafshëve. Pse bash ato kafshë?

Ah, se kur isha e vogël, vajza e axhës, e kishte nji macë, e flinte me to. Na ishim moshatare, e kishim ni shtëpi të vjetër, e flejshim bashkë. Macen e lijke në mes. Mandej kur jemi konë me qira, ka qenë ni dritare, ka qenë ni kulm aty, me tjegulla të vjetra, aty lujshin macat. Pata thonë "Qysh kom me bo qëtash ni grafikë, ni maçok e ni macë tu lujtë me ni litar e tu çu dashni" {qesh}. Nuk janë tu u përla, janë tu çu dashni. E ato në fotele, e kom qat fotele në shpi, e thash hajt ta boj qët fotele, hajt ta boj ni macë qaty, hajt ni konzervë le t'përlahen qaty {qesh}.

E ato me pallua që e ki?

E ato ma vonë e kom punu, masi që e kom kry akademinë.

Këto me maca jon para se me kry akademinë?

Këto macat jonë të diplomës, i kemi pasë, detyra. Një e katërta të plloqës na ndajshin në akademi, e qaty punojshim. Une e kom pasë Zydi Qakolli, ka vdekë, ishim në vitin e katërt, e në të tretin punojshim bashkë. Nekra me gru ka qenë, Lulen.

E kërmili?

Se kur jemi konë në Gjakovë ka pasë shumë kërmij {qesh me të madhe}.

Ke vendosë që figura kryesore kanë qenë kafshët?

Po ha-ha, mandej fillova me portret, po e ndala. I bona tri portrete, pasi që e kryva akademinë, po mandej…



Cila të ka pëlqy ma shumë? Me kafshë a me portrete?

Jo, tash dojsha me bo portrete, pak femnën me e ngritë. Me qitë pak në pah punën e saj. Që femna edhe pse e ka një barrë të rëndë, po e ka atë të bukur. E pëlqyshme prej tjerëve, edhe e mban me krenari! Krynë shumë punë, edhe është e pëlqyeshme, po mendoj kah pamja, jom mundu me i bo t'bukura.

A e din në cilin vit jonë bo pjesë e koleksionit të GKK-së punimet tua?

E para, Shyqa [Shyqri Nimani] kur ka qenë, është jo qëkjo që e kom pikturu, po është edhe ajo teknikë, po ndryshe. '82 duhet me qenë kur e kom punu palloin e parë. E ato ma ka ble Galeria, po Vlora [Hajrullahu, kordinatore edukimi në GKK] po thotë s'është aty. Nysret Salihamixhiqit ia blejnë pikturën, mu ma blejnë grafikën. Une isha me gjithë qejf…

Kur është ardhë Tita [Josip Broz Tito, President i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë] herën e fundit, mu tri grafika t'mija mi blejnë edhe ia falën. Ato me siguri janë në muzeun e 25 majit në Beograd.

Cilat punime i blejtën?

Ata e murën, "Peshkun e kuq", "Macat", dhe ndoshta "Kërmijtë" kom harru. Veç 3 punime. Hera parë që mora pare une {qesh}.

Qysh ke si ndjenjë?

Ndjenjë e mirë! Ha-ha-ha. Edhe kjo në Galeri, 1982, a po Fatmir? "Nën Puplat e Palloit", e bukur ishte.

Pllakat e grafikave nuk i ki a?

Jo nuk kam mujtë me i gjetë.

Sa vjet ke dhonë mësim?

40 vjet.

Çka kishe veçu diçka nga kjo periudhë? Cila të ka pëlqy ma shumë?

Më së gjati kom punu në [shkollën fillore] “Naim Frashëri,” kam punu në Obiliq, tetë vjet e gjysë, kam punu në Gjakovë, e në Pejë, po në Obiliq u kanë hapësira ma e madhe, aty e kam pasë kabinetin shumë të mirë, por nxanësat shumë të varfër. Ia u merrsha bllokat, i qitsha në dollapa dimrit se iu bijshin. I lutsha “Hajdeni me punu.” Njiherë u konë ni nxanës me patika dimrit, krejt qull. Une i kisha edhe ni parë çarapa t’shkurta përmi, ia pata dhonë se krejt komtë akull. A din kanë qenë shumë të mirë. Kolektivi shumë i mirë.

A kishe dashtë me bo ndonjë ekspozitë me punimet e tua, a e ki mendu ndonjëherë edhe gjatë viteve sa ke qenë tu punu në arsim?

Jo, deri mbas lufte, punojsha kur kishte Fatmiri ndonjë ekspozitë. Ka ndodhë në Amerikë dy për njëhere i ka pasë, atëherë kur e kisha tirazhin i ndihmojsha. Une e pata lonë punën teme, e i ndihmojsha, qaty çka kishte punë teknike. Edhe ka magjistru ky, edhe me fitu, se na ishim shtatë vjet me qira, ma shumë se gjysa e rrogës, na vyjke me pagu qira, se e kishim marrë krejt katin. Neve na vyjke, atelieja, kishim mysafirë. Sa mysafiri ka ardhë, me punë, jo veç me ndejtë. Prej Pejës, prej Gjakovës.

A Galeria Kombëtare në fillim ka qenë në Boro Ramiz…

Po qaty, qajo ka qenë Galeri.

Qajo të ka pëlqy a?

Ka qenë e madhe, e aty qendër, çka ka pasë vizitorë. Tash s’ka qashtu.

Hyrije Krypa
*Palloi*, 1978
Linogravurë
53 × 69 cm
(Edicioni 1/6)



Hyrije Krypa
*Peshku i kuq*, 1980
Teknikë e kombinuar
75 × 53.5 cm
(Edicioni 6/15)



Hyrije Krypa
*Kërmijtë*, 1980
Akuatinë me ngjyrë
54 × 70 cm
(Edicioni 1/5)



Hyrije Krypa
*Loja e macave*, 1981
Teknikë e kombinuar
75.5 × 53 cm
(Edicioni 5/15)



Hyrije Krypa
*Nën Puplat e Palloit*, 1983
Teknikë e kombinuar
54 × 62 cm



Hyrije Krypa
*Ganimete Tërbeshi*, 1983
Teknikë e kombinuar
62 × 85.5 cm
(Edicioni 2/15)



# Anton Gllasniqi





**Galeria e Arteve**
Pallati i Rinisë
„Boro-Ramizi"
Prishtinë

**Galerija umetnosti**
Dom omladine
„Boro-Ramizi"
Priština

**Gallery of Arts**
The Youth Palais
„Boro-Ramizi"
Prishtina



**ANTON GLLASNIQI, lindi në Ferizaj më 1937. Akademinë e Arteve Figurative dhe Shkallën e tretë e kreu në Zagreb.**

**Rodjen 1937. godine u Uroševcu. Akademiju likovne umetnosti i postdiplomske studije završio je u Zagrebu.**

**né à Ferizaj en 1937. Diplome de l'Académie des Beaux-Arts de Zagreb.**

**Etudes post-universitaires egalement à Zagreb.**

**Adresa: Ferizaj, Lenjinit 10**

EKSPOZITAT PERSONALE:

1968 — Split, Saloni d'art
1969 — Beograd na moru „Galeria mladih",
1972 — Ferizaj, galeria „Zef Kolombi",
1974 — Ferizaj, galeria „Zef Kolombi"

EKSPOZITA KOLEKTIVE:

1968 — Zagreb,
— Split,
1969 — Biograd na moru
1972 — 1974
— Prishtinë, ekspozita e SHAFK,
— Mitrovicë "
— Gilan, "
— Gjakovë "
— Pejë, "

SHPËRBLIMET:

1968 Shpërblimi në Solonin e të rinjve Zagreb,

1969 Shpërblimi i parë për pikturë i Akademisë së Arteve Figurative Zagreb.

KATALOGU:

4 — Dy figura, vaj 130 × 100,
5 — Dy figura, vaj 120 × 110,

SAMOSTALNE IZLOŽBE:

1968 — Split — Salon d'art
1969 — Biograd, na moru, „Galerija mladih"
1972 — Uroševac, galerija „Zef Kolombi",
1974 — Uroševac Galerija „Zef Kolombi".

GRUPNE IZLOŽBE:

1968 — Zagreb,
— Split,
1969 — Biograd na moru
1972 — 1974
Priština izložba ULUK
Gnjilane "
Gjakovica "
Peć "

NAGRADE:

1968 Salon mladih Zagreb
1969 Prva nagrada za slikarstvo — Akademije likovne umetnosti Zagreb,

KATALOGU:

4. Dve figure, ulje 130 × 100
5. Dve figure, ulje 130 × 100

**BIBLIOGRAFI-JA:**

**„Rilindja" 63, E. Berisha, 68 Dr. Zef Mirdita, 68, T. Bebić, Parathënje e katalogut 74 Dr. Z. Mirdita.**

kulturë arësim kulturë arës

22-VIII-72



Mr. Anton Gllasniqi, përfaqsues i SHAFK në bisedë me përfaqsuesin e Rivistës „Mermeri dhe tingujt"

NË KUADRIN E RIVISTËS SË ARTIT JUGOSLLAV NË ARENGJELLOVC

# U HAP EKSPOZITA E ARTISTËVE FIGURATIVË TË KOSOVËS

Në kuadrin e Rivistës së artit jugosllav „Mermeri dhe tingujt" në Arengjellovc u hap këto ditë një ekspozitë kolektive e artisëve figurativë të Kosovës. Kjo u hap solemnisht dhe me këtë rast morën pjesë shumë personalitete të shquara të jetës kulturale të Arengjellovcit dhe të qyteteve të tjera të Sërbisë Qendrore.

Artistët figurativë të Kosovës i paraqiti para vizitorëve Mihajllo Razhnjatoviq, publicist nga Beogradi. E pastaj Shoqatës së piktorëve dhe skulptorëve të Kosovës iu dorëzua Plaketa „Mermeri dhe tingujt".

Ekspozita e artistëve figurativë të Krahinës sonë do të jetë e hapur deri më 27 të këtij muaji. Në të janë ekspozuar punimet e **Nebih Muriqit, Musllim Mulliqit, Rexhep Ferrit, Hilmi Çatoviqit, Nusret Salihamixhiqit, Svetozar Kamenoviqit, Tahir Emrës, Engjell Berishës, Kadrush Ramës, Verolub Radoviqit, Hysni Krasniqit, Xhevdet Xhafës, Radosllav-Musa Miketiqit dhe të Svetomir Arsiqit.**

Që në ditët e para ekspozita kalektive e artistëve figurativë të Kosovës zgjoi interesim të madh ndër vizitorët.



EKSPOZITA

# FIGURA SI PREOKUPIM MË I GJERË

**● Me rastin e hapjes së ekspozitës së SHAFK « 25 vjet të Shoqatës së Artistëve figurativë të Kosovës» në Galerinë e Arteve të Kosovës**

Me rastin e jubileut të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës njëzetepesëvjetorit të aktivitetit të saj, në Galerinë e Arteve të Kosovës është e hapur ekspozita «25 vjet të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës». Veprimtaria e gjerë e kësaj Shoqate dhe e anëtarëve të saj është e përcjellë me të arriturat dhe vlerat e një arti bashkëkohor.

Nga më se 120 anëtarë të rregullt të SHAFK, në këtë ekspozitë janë prezentuar 63 krijues me afro 70 vepra në lëmin e pikturës, skulpturës dhe të grafikës. Në këtë prezentim pjesëmarrësit është dashur të ekspozojnë realizimet e tyre më të sukseshme nga e tërë veprimtaria e tyre njëzetepesëvjeçare. Mirëpo, zgjedhja e punimeve qoftë nga ana e komisionit apo ndoshta më tepër nga «pakujdesia» e autorëve, nuk na ka dhënë në këtë ekspozitë një prezentim të denjë të të arriturave të artit tonë bashkëkohor. Me këtë pos tjerash nënkuptojmë se është dashur të prezentohen realizimet më spikatëse të çdo anëtari. Disa prej tyre kanë sjellë realizimet më të reja, megjithëse kjo nuk do të thotë se ato duhet të janë edhe më cilësoret.

Ndër 63 autorë janë prezentuar edhe krijuesit më eminentë kosovarë si M. Mulliqi, E. Berisha, V. Radoviq, R. Ferri, S. Arsiqi, A. Çavdarbasha, Fatmir Krypa, S. Kamenvoqi si dhe autorë të tjerë që u përkasin të tri gjeneratave.

Përderisa Muslim Mulliqi në pikturën e vet tregon ekspresionin, intensistetin, kontrastin dhe mjeshtërinë e perfeksionimit piktural, në sfondon e kuqe të pikturës së Engjëll Berishës (Medalonet e Prizrenit XXX) hasim portat e vendosura dhe rozetën e pëzulluar. Që të katër këto elemente përmbajnë në vete një kompleks simbolesh që tregojnë një rrëfim të së kaluarës i cili jeton në botën shprehëse të piktorit që përherë ka për pikënisje vatrën, zjarrin ngrohtësinë... Anton Gllasniqi me figurën që paraqet bën njëfarë sinteze, e cila kryehet përmes raportit apo ndarjes hijësore. Katrorët e inkuadruar herë pas herë shërbejnë, sipas të gjitha gjasave, të tregojnë komparacioni, i cili konsiston në aplikimin e teknikës piktur ale që ka përvetësuar ky krijues. Figura në pikturën e këtij autori asnjëherë nuk është paraqitur në tërsi, mirëpo analizimi anatomik i kokës, i ndonjë elementi tjetër apo edhe i ndonjë forme tjetër të pjesërishme ka të bëjë me një afinitet e kreacion jo edhe aq të rrallë. Piktura e Isa Alimuasajt shikuar vizuelisht vetëm formën figurale koincidon pamëdyshje me skulpturën e Agim Çavdarbashës. Këta të dy bëjnë reduktimin e figurës njëherësh atë e paraqesin të shikuar në tërësi, mirëpo duke i dhënë theksim të posaçëm lëvizjes njehersh edhe pozitës. Skica e bardhë e ekspozuar në kryeqendrën tonë për herë të parë na sjell një impresion të ri lidhur me punën e Petar Gjuzës, piktura paraprake e të cilit dallon rrëjësisht nga kjo. Në këtë pikturë autori ka krijuar një vepër të re me ndihmën e materialit të ri që sjell në të. Liria, loja dhe hedhja e elementeve, manipulimi me to, aplikimi i spagës në të është kërkesa për një risi te ky autor, i cili krahas Xhevdet Xhafës tenton të krijojë pikturë taktile e cila në artin bashkëkohor është gjithnjë e më shumë e pranishme.

Shprehjen e rrëfimit origjinal dhe e trajtimit besnik të veprës e hasim te grafiku i gjeneratës më të re, Ymer Shaqiri. Vepra e tij qoftë grafika apo edhe vizatimi, në çdo prezentim bën të na befasojë. Posaçërisht tërheq bota e veçantë, ende e pazbuluar e këtij krijuesi.

V. NURA



Ymer Shaqiri: Vizatim

E premte, 14. I. 1983.

RILINDJA







Hapësira e Gllasniqit është qetësi. Ajo shquan trajtat lirike të vizatimit të laviruar. Kombinimi i trajtave lirike dhe vijave grafikore krijon tërësi. Vijat stabile dhe trajtat lirike ndërtojnë strukturën. Hapësira e zbrazët dhe drejtpeshimi i trajtave në të krijon qenien apstrakte. Optika e hapësirës sugjeron materjen makrokosmike dhe mikrokosmike.

– Nebih Muriqi, "Artisti i pikëpyetjeve: Bienali i tretë i vizatimit"

Me 3 prill 1979, në Galerinë e Arteve të Kosovës e cila në atë kohë gjendej në Pallatin e Rinisë "Boro e Ramizi", u hap Bienalja e Tretë e Vizatimit. Në mesin e 49 artistëve, listohet edhe piktori Anton Gllasniqi.

Ndonëse vepra e tij me këtë rast nuk kishte fituar asnjërin nga tre shpërblimet kryesore, kronikuesi i rregullt i artit pamor dhe piktori Nebih Muriqi e kishte përfshirë në recensionin e tij të Bienales, të botuar në revistën *Fjala*. Në këtë artikull një-faqësh ku Muriqi flet mbi veprat e shumë prej pjesëmarrësve të Bienales, në një paragraf të shkurt e të pazbardhshëm, ai e thekson në veprën e Gllasniqit dominimin e zbrazëtisë dhe vijave që i japin forma një shprehjeje abstrakte. Duke qenë që vizatimi apo vizatimet e Gllasniqit nuk e shoqërojnë tekstin e artikullit, mbetet mister se si janë dukur ato ashtu siç mbetet në masë të madhe edhe vet autori i tyre.

Recensioni i mësipërm është një nga tekstet e rralla për punën e Gllasniqit. Të dhënat mbi jetën dhe veprën e tij janë shumë të pakta. Dy nga veprat e tij janë të ruajtura në Koleksionin e Galerisë: "Katallani" dhe "Kompozicion"—të dy piktura me vaj në pëlhurë. Galeria nuk ka të dhëna mbi vitin e krijimit dhe atë të koleksionimit të këtyre dy veprave. Në një dokument të gjetur në Arkiv të Galerisë, megjithatë, e kuptojmë që janë blerë nga 700,000 dinarë secila.
Anton Gllasniqi ka lindur në vitin 1938 në Ferizaj dhe vdiq në vitin 2017 në Zagreb. Varri i tij gjendet në Dubrovnik, Kroaci.

Nëpër mbulime mediale dhe katalogje të ekspozitave kolektive, Gllasniqi gjendet në mesin e gjeneratës së parë të artistëve figurativë të Kosovës: emri i tij përmendet bashkë me Muslim Mulliqin, Nysret Salihamixhiqin, Engjëll Berishën e shumë të tjerë. Sikur shumica e piktorëve të asaj gjenerate, ai ishte edhe ligjërues në Fakultetin e Arteve, ku kishte ligjëruar “Teknologjinë e Pikturës,” post që kishte mbajtur edhe gjatë viteve te ‘90ta kur shumica e shqiptarëve ishin larguar masovikisht nga puna nga regjimi i Milloshevigit. Sipas informatave të nxjerra nga intervistat, pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, Gllasniqi kishte vazhduar të punonte si profesor në Universitetin e shpërngulur të Prishtinës në Mitrovicë deri në pensionim. Çarja politike dhe shpërngulja e mëvonshme e Gllasniqit në Kroaci, me siguri kanë kontribuar në harresën e tij si një nga figurat e para të ekspresionizmit abstrakt në vend.

Sipas ish-studentit dhe mikut të tij piktorit dhe profesorit Faik Krasniqi, në vitet e fundit të jetës së tij Gllasniqi kishte qenë dukë përgatitur një monografi retrospektive të punës së tij.

Në vijim janë dy intervista të redaktuara me artistët dhe profesorët Faik Krasniqi dhe Mehmet Behluli, të dy ish-studentë të Gllasniqit.



## Intervistë me Mehmet Behlulin

Mehmet Behluli, artist, kurator dhe ligjërues në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, e kishte njoftuar Anton Gllasniqin si ligjërues gjatë kohës që studionte pikturë në Prishtinë. Në atë kohë, Gllasniqi ligjëronte lëndën “Teknologji të Pikturës.”

Pasi që e kontaktuam si pjesë të punës sonë hulumtuese, Behluli kishte kërkuar Anton Gllasniqin në internet dhe ishte befasuar që nuk kishte gjetë asnjë burim a informatë *online* për të. Gjatë intervistës që zhvilluam përmes Facebook Video derisa Behluli gjendej në Colombo, Sri Lanka në gusht të vitit 2023, ai me keqardhje e pranoi se edhe vet kujtesa e tij në lidhje me punën dhe jetën e Gllasniqit ishte e kufizuar. Për Behlulin, kontributi i Gllasniqit në radhë të parë kishte qenë si pedagog e ligjërues në fakultet, se sa si krijues aktiv por megjithatë ai insistoi që Gllasniqi kishte qenë pjesë e rëndësishme e skenës artistike të Prishtinës.

Çka mund të na tregoni për Anton Gllasniqin?

> Artistët bëhen ja në menyrë institucionale, ja gjysëm institucionale. Qe për shembull, Anton [Gllasniqi] me neve ka qenë vazhdimisht, ndërsa unë tash s’po muj me gjetë asnjë informatë për të. Shumë u befasova...shumë, shumë. Katalogët i keni pa, apo jo, ato që i ka pasë në Galeri?

Po. Janë katalogët e disa ekspozitave grupore. Nëse e ka pasë ndonjë ekspozitë personale, nuk kemi gjetë katalog për të.

> S’gjetët asgjë...Këtu [në internet] s’më del kerkah hiç Antoni—hiç kërkah. Po si duket edhe se s’ka qenë shumë aktiv. Ai ka qenë në shoqëri me Shyqri Nimanin, Muslim Mulliqin, me Nysret Salihamixhiqin. Kanë qenë kështu, bohemë, profesorë, artista shumë t’mirë... qata që i kemi!
>
> Ai ka pasë edhe shume ekspozita vet. Unë sa e mbaj n’mend, ai ka pasë shumë ekspozita. Kështu si artist nuk ka

qenë edhe shumë aktiv, si duket, po i rëndësishëm ka qenë për neve sepse nga gjenerata e tij nuk kemi pasë ne shumë artista. Në gishta të dorës mund t'i njehim.

Mu m'ka dhënë "Teknologji te Pikturës," i kemi thonë. Ka qenë njëfarë lënde relativisht lëndë praktike. Bile bojshim hajgare me Antonin, thojshim, "Profesori i teknologjisë a vet pikturat i ka krejt t'shtremta...." A po merr vesh? Ato rama... {qesh} kërkah hiç. E po, e kemi pasë mik... Shumë mik...Ishte i hareshëm kështu që kemi kalu mirë.

Lënda qe e ka dhënë ai, ka qenë lëndë shumë e rëndësishme, se në atë kohë arti ka qenë shumë më shumë fizik se sa që është sot konceptual. E ki parasysh?

Na te gjithë kemi qenë të shkathët me pikturu' e me vizatu', sepse jemi trajnu shumë më shumë se sa që trajnohen sot. Sot, gjenerata ime e profesorëve, tentojmë me e stimulu ma shumë pjesën kreative, pjesën ideore, konceptuale. Në atë kohë ka qenë pak ma ndryshe.

Atëherë, sepse kur është themelu Fakulteti ynë, sigurisht intenca ka qenë ma shumë politike. N'atë kohë kur është themelu shqiptarët e Kosovës kanë marrë pak ma shumë te drejta se seç kanë marrë përpara, edhe ka ardhë momenti me u themelu edhe universiteti n'gjuhën shqipe për neve.

Po kur është themelu, model e kemi pasë—normalisht, s'kemi mujtë me pasë Nju Jorkin, se s'e kemi ditë bile qe ekziston Nju Jorki—por e kemi pasë Beogradin, Zagrebin, Ljubljanën, edhe tani Sarajevën. Këto kanë qenë modelet prej t'cilave na kemi marrë. Bile edhe profesorat i kemi pasë prej Beogradit, mandej nji kohë kemi marrë edhe profesora prej Tiranës, që kanë qenë për kohën shumë problem ideor, konceptual. Se ata [profesorët e Tiranës] kanë qenë "*fully*" në, si me thonë, në social-realizmin e tyre...në artin e dirigjumë prej partisë. A na [në ish-Jugosllavi] s'kemi pasë lidhje me ato punë.

Na kemi qenë vend komunist, socialist, mirëpo arti në ish-Jugosllavi u bo shumë i çlirë... Është punu shumë çlirë, shumë.... Përpos që s'ke guxu me prekë, çështje nacionale—veç mos u përzi anej, s'ke pasë asnji problem hiç.



Pasi për vet Antonin s'keni shumë informata, a mund të na tregoni diçka për gjeneratën e tij?

Për gjenerata mund të flas. Kështu, gjenerata e Antonit është gjenerata e parë e këtyre artistëve qe kanë pru diçka prej territoreve të ish-Jugosllavisë, sepse na qashtu jemi kriju...

Profesorët tanë, gjenerata e parë që kanë shku me u shkollu jashta Kosovës, ata, secili ku ka ndejtë, kanë pru një pjesë prej atij ambientit, një pjesë të asaj kulture. Kjo për mu ka qenë shumë interesant, shumë bukur, shumë atraktive, sepse ashtu edhe ne jemi mbaru masnej, gradualisht ia kemi nisë me bo traditën tonë. Kështu që, Antoni është një prej artistave të Modernes Kosovare, mos t'i them shqiptare, e cila fillet i ka diku rreth viteve t' 70-ta, kur edhe i kanë përfundu shkollat.

Prej të parëve jane këta: Muslim Mulliqi, Nysret Salihamixhiqi, Rexhep Ferri. E në këtë gjeneratë, është edhe Antoni... E studimet sa e di une i ka kry në Zagreb, edhe e ka pasë njëfarë figuracioni interesant, të cilin e ka kultivu, por fatkeqësisht, unë po them, mendimi jem personal është qe ai nuk ka qenë edhe aq aktiv si krijues, por si mësues, si shok, si një prej pjesëtarëve të komunitetit shumë interesant, pra shumë i rëndësishëm ka qenë edhe Anton Gllasniqi. Eh, ka qenë një shoqni e profesorave, që kanë qenë, kështu pak ma shumë bohem...

Kështu pak ma shumë që e dojnë jetën... nuk o' krejt veç te puna, po edhe kanë punu. Ata në të vërtetë edhe e kanë themelu Fakultetin e Arteve në njëfarë forme. Fakultetin e themeloi Muslim Mulliqi me kolegët e vet, tani këta gradualisht, pak ma te rinj, vijnë, edhe bohet Fakulteti si ka qenë.

Për krijimtarinë e Gllasniqit, unë nuk di shumë me të tregu. I mbaj në mend pikturat, por s'di me të kallëzu më shumë.

A mos e dini pse nuk ka qenë pjesë e ekspozitave edhe nuk është permend më në këto 20-30 vitet e fundit?

> Sepse ka mbetë me punu me [serbët], e kjo ka qenë një prej arsyeve pse të tanët me njëfarë forme e kanë anatemu, gjë me të cilën unë nuk jam pajtu' kurrë, unë tash po foli për veti. Unë mendoj që ajo pjesa politike ai ka gabu, ndoshta ka gabu. Mirëpo ajo ka qenë çashtje krejtësisht tjetër, s'ka t'bëjë ajo me krijimtari. Sikur edhe Hilmija Ćatovići…
>
> Në 91-shin, kur na kanë qitë prej ndërtesave [të Universitetit], na jemi riorganizu dhe kemi punu nëpër bodrume ndërsa disa kanë mbetë në [sistem], ndonëse shqiptarë kanë qenë të rrallë që kanë punu me [serbë]. Një prej tyne ka qenë Anton Gllasniqi, po unë e mbaj në mend për të mirë, nuk kom asi telashe me thonë jo ka punu, jo s'ka punu. Ai e ka ditë vet pse ka punu [me serbë], ajo është çështje krejt tjetër. Por, sa kemi qenë na bashkë, kemi qenë shumë, shumë të afërt, shumë të mirë.
>
> Po, pra, Antoni, Hilmija Ćatović edhe disa tjerë kanë mbetë një kohë me ta, mandej kur u pa saktë që s'ka mundësi me bashkëpunu, atëherë edhe ata pak që ishin shqiptarë u tërhekën dhe normal [serbët] vazhduan deri në '99-tën derisa u prish [situata]. Kur u prish, mandej e ndjekën këta secili anën e vet. Kjo është krejt e lidhur edhe me politikë, s'ki çare pa e theksu edhe këtë fakt.

Po, patjetër.

> Por unë nuk jam pajtu' me këta kurrë, që me i anatemu veç pse ka qenë orientimi politik ndryshe, edhe pse këtë me thënë publikisht është pak zor, se nuk t'kuptojnë njerëzit. S'e marrin vesh qe arti është art.
>
> [Anton Gllasniqi] e ka lënë një pjesë te vetën këtu te na, me neve. Kohë të gjatë ka qenë me neve, mandej kur ka përfundu, qysh ka përfundu situata, ai ka ikë prej këtu. Në fakt, s'ka ikë, ka shku' prej këtu sepse ai ka ardhë kohë pas kohë, i ka vizitu miqtë e vet në Kosovë….por, por…vend nuk ka pasë ma për të.

A mundesh me më tregu pak për këtë periudhë?



> Kjo gjenerata ime Simon, kur u prish…pas vitit '99, [artistat e vjetër] nuk dishin me gjetë bash mirë pluralizmin politik. A din? Këta prapë mendojshin që kjo është shoqata e artistave, është një Fakultet i Arteve…Pluralizmin thjesht nuk e kuptojshin, mendojshin që duhet me qenë një parti… Nuk e kuptojshin. Ata mendojshin që ashtu duhet prapë me qenë, që dikush i dirigjon, dikush i kallëzon qysh me bo [art]. Ndërsa ne që ishim pak ma të ri —në atë kohë ishim bajagi të ri—ia nisëm me shpërthy sepse tu e ditë qysh është situata, duhet dikush me zënë hapësirën tënde qashtu qysh ta merr mendja, qysh mundesh ti vet me kontribu.
>
> Kështu që masnej, na që ishim një grup të rinjsh, artista në atë kohë të ri, ia nisëm me gjithfarë aktivitete. Hajde pak ekspozita, e pak projekte, e pak artista të huaj me i ftu te na…
>
> A këta [gjenerata e vjetër] nuk ditën me u gjetë e këta sot e asaj ditë mendojnë që duhet me qenë Shoqata e Artistave e cila na dirigjon. Gjë që unë nuk mendoj që është ashtu. Mund të ketë Shoqatë të Artistëve, patjetër, po jo vetëm një shoqatë. Mund të jenë më shumë qysh edhe ekzistojne në një sens, a po jo?

Në Koleksion të Galerisë jane vetëm dy vepra të Antonit. Tjerat s'kemi arritë me i gjetë. Nëse e dini, a ka pasë Gllasniqi periudha të ndryshme të veprimtarisë? A i ka ndërru stili prej periudhës në periudhë, ose a ka qenë ndryshe kur ka punu në Prishtinë prej veprave të mëvonshme?

> Siç të tregova, mendoj që e meta e tij ka qenë që nuk ka qenë shumë aktiv si krijues. Ai ka punu shumë, po kështu nuk e di sa ka arritë me evolu' ose me ndryshu si artist. Pra, aktiv ka qenë, po në Fakultet Arteve po, bile, bile më duket se një kohë ka qenë edhe prodekan në Fakultet të Arteve. Ka qenë një prej personave shumë të rëndësishëm të skenës, por si krijues nuk di me të të tregu ma shumë… Nuk kam parasysh diçka që duhet me u përmend. Ka qenë pjesë e artistëve t'parë t'Kosovës – ato duhet patjetër me e cekë. Por, jo që ka qenë ndonjë avantgarde, siç ka qenë për shembull Muslim Mulliqi apo Nysret Salihamixhiqi, apo Xhevdet Xhafa, apo

Rexhep Ferri. E tash kjo është kategoria tjetër, edhe Hilmija [Ćatović] unë mendoj që ka qenë relativisht aktiv, por fakti është që këta shumica kanë qene t'tanët [shqiptarë]...

Ti po e din se si, problemet tona nacionale, urrejtja ndërnacionale, apo ku ta di unë — këto e kanë ba t'veten.

Kur ka qenë hera e fundit që i ke pa këta personazhe, pra Anton Gllasniqin apo Hilmija Ćatovićin?

Unë kam studiu në vitet '83-87. Në vitin '87 kam diplomu në Prishtinë dhe menjëherë kam shku në Sarajevë me studiu. Studimet post-diplomike i kam kry në Sarajevë. Atje kam ndejtë nja tre vite. Po këto kanë qenë tre vite shumë të rëndësishme se në vitet 1988-91 filloi shpërbamja e Jugosllavisë. Ia nisën me ndërru sendet shumë shpejt. Millosheviqi erdh në pushtet e i shpejtoi gjanat.

Sllovenia u nda, nisi lufta në Kroaci. Unë i kam përfundu studimet pak para se me ia nisë lufta në Bosnjë dhe jam kthy në Prishtinë. Në vitin 1991 jam kthy n'Prishtinë, mirëpo prapë s'kam ndejtë në Prishtinë, kështu që krejt këta njerëz i kam pa mas vitit 1987, shumë pak.

E kam pa Muslim Mulliqin deri në vdekje, e i kam pa këta tjerët kur jam kthy. Në vitin 1991, na ia nisëm njëfarë aktiviteti, ta këqyrim çka o' arti bashkëkohor, qysh bohet, pse bohet... Po me këta [gjeneratën e vjetër të artistëve] ka qenë vështirë sepse na kishim ambicie, interesime, krejtësisht të tjera artistike. Edhe thjesht nuk u përputhshim konceptualisht...po edhe nuk kanë qenë aktiv. Sidomos mas '91-tës, kur u prish gjithçka, shumë pak kanë qenë aktiv.

Okej. Po Ćatovići ka qenë po ashtu profesor. A iu ka dhënë ai mësim?

Jo, Hilmija nuk më ka dhënë lëndë. Ai ka pasë klasën e vet të pikturës, sepse atëherë mësimi ka qenë i organizumë nëpër klasa siç është edhe sot, për shembull secili e ka një klasë të pikturës, të lëndës kryesore. Këto i kanë dhënë Hilmija, Tahir Emra, Rexhep Ferri, Muslim Mulliqi. Ata e kanë pasë grupin e studentëve të tyre. E pastaj i ke marrë lëndët teknike, si ajo që e ka dhënë Anton Gllasniqi. Po zakonisht ne shqiptarët shkojshim tek shqiptarët, e këta që kanë folë sërbisht tek ata që kanë folë sërbisht. Përpos që te Muslim Mulliqi kanë ardhë edhe shumë që kanë folë serbisht se Muslimi ka pasë marrëdhënie të mira me të gjithë. Mësimi është mbajtë edhe në shqip edhe në sërbisht.

A e mban në mend dikë që ka qenë në klasë të Ćatovićit?

Jo. Na kemi qenë relativisht aktiv deri n'fillim t'90-ve a din? Nëpër galeri të tona, këtu i kemi pasë [artistët e të gjitha etnive]. Po mandej, po, na kanë qitë prej Galerisë, mandej ka qenë e vështirë me u taku edhe nëpër galeri, e masnej thjesht na i kemi bojkotu [serbët] dhe ata na kanë bojkotu neve, dhe komunikimi ka qenë zero. Zero.

E masnej jeta është organizu nëpër bodrume, ata kanë mbetë nëpër institucione. [Serbët] as 10 përqind s'kanë qenë, na 90 përqindshi kemi qenë nëpër bodrume, kësi budallakina që ndodhin në Ballkan, siç po ndodhin sot e kësaj dite.

Me Antonin për shembull, per me dalë, ku ka qenë vendi per me dale e me pi një raki?

Te Llausha... A e din ku ka qenë Llausha? Te ajo rrugica mes Arkitekturës edhe Ministrisë së Arsimit? A e ki parasysh? E qaty ka qenë një rrugicë, aty ka qenë njëfarë kafe e vogël, te Llausha. Te Syl Llausha, qaty kanë ndejtë këta vazhdimisht.

Antoni thjesht s'më kujtohet që është përzi shumë me neve mas '90-ve. Nuk më kujtohet. Deri atëherë po, mas jo, nuk po m'kujtohet.



Anton Gllasniqi
*Kompozicion* (p.d.)
Vaj në pëlhurë
71 × 92 cm



Anton Gllasniqi
*Katallani* (p.d.)
Vaj në pëlhurë
184.5 × 130 cm



Anton Gllasniqi dhe Faik Krasniqi në picerinë "Leo", Prishtinë.
25 shkurt 2007



Faik Krasniqi, piktor dhe dizajner grafik, kishte qenë student i Anton Gllasniqit në Universitetin e Prishtinës dhe më vonë mik i tij. Gjatë një bisede të pa-strukturar në atelenë e tij afër Hotelit Grand në Prishtinë të bërë në shtator të vitit 2023, Krasniqi ndau me ne kujtimet e tija me Gllasniqin, të cilin e mban mend si artist që kishte eksperimentuar me teknika dhe si profesor nga i cili kishin mësuar bazat e teknikave të pikturimit.

Krasniqi e kujton Antonin edhe si person gazmor e bujar. Kur ishte i ri Krasniqi dhe miqtë e tij kalonin kohë në bregdetin kroat— në Babinkuk, Cirkvenicë e Rab—duke fituar para duke bërë portrete turistësh në rrugë. Në një nga këto epizode, Krasniqi kujton se si Gllasniqi i kishte dalë në ndihmë kur bashkë me një mik kishin mbetur trokë duke u bredhur lartë e poshtë Evropës.

Gjatë viteve të '80ta, kur vendi ishte futur në një krizë të thellë politike dhe ndasitë etnike kishin dalë në pah, Krasniqi thotë se Gllasniqi ishte deklaruar si kroat, pasi që e ëma e tij ishte kroate (duhet shënuar që në databazën e Galerisë, ai është i dokumentuar si artist shqiptar). Gjatë viteve të '90-ta kur shqiptarët ishin larguar masovikisht nga puna në të gjithë sektorin publik, Gllasniqi kishte vazhduar të punonte në Fakultetin e Arteve. Për këtë arsye, Krasniqi mban mend, ai edhe ishte ngacmuar e persekutuar pas luftës si dikush që kishte bashkëpunuar me serbë. Megjithatë Krasniqi insiston që Gllasniqi "s'i kishte bërë dëm kurrë askujt."

Çfarë mund të na tregoni për Anton Gllasniqin?

Anton Gllasniqi, përndryshe Gllasnoviq, është i deklarumë si kroat në fund të 80-ve. Edhe ai ka punu deri n'pension ka punu në veri t'Mitrovicës, në Universitetin e Prishtinës në Mitrovicë. Unë e kom taku pas luftës, ka ardhë disa herë këtu te unë. Edhe ai ka shku' [në Kroaci] se e ka

pasë shtëpinë në Zagreb, edhe kom ndëgju që një këmbë ia kanë amputu' e më vonë edhe ka vdekë. Për ma tepër nuk di. Duhet me pasë parasysh që ai ka qenë duke e ba gati *Monografinë*, të cilën kam pasë unë me ia punu, po materiale s'kam kurgja prej tij. E i pat mbledhë bukur shumë materiale. I pata thënë "Ku po don me i qitë n'Monografi tanë këto..."

Do të thotë i ka pasë gati materialet?

Shume afër... E ma vonë ka vdekë, e kam marrë vesh prej një shokut që e kom n'Cirkvenicë aty afër Rjekës që e ka njoftë, njejtë e ka pasë profesor edhe ai në Akademi dikur...e ai m'ka tregu që ka vdekë. Ka qenë ashtu tip gazmor pak a shumë edhe...n'skijim ka shku shumë shpesh. Deri vonë ka shku.

Sa i përket krijimtarisë, ato punime a i ka n'veri [të Kosovës], a po nuk i ka... s'e di.

Si e kishit përshkruar stilin e veprës së Antonit?

Koloritin që e ka perdorë ai, bash kom bisedu me to, se kemi nejt n'Leo [piceri në Prishtinë] pas luftës disa herë. Atë kolloritin e ka pasë sikur piktura në kohën e Romës. Janë do freska që e kanë atë farë kolloriti si ngjyra t'dheut. Ato ai i ka përzgjedhë, por më thellë m komentu s'po di si. Me i pasë punimet përpara, ia kishim ngjitë emrin diqysh {qesh}. Ai s'ka punu gjithnjë ashtu. Për shembull, pikturat që i ka Galeria [Kombëtare e Kosovës] — ato janë krejt tjetër stil, janë prej periudhës së tij më të hershme, që i ka ba pak ma abstrakt. Me teknikën, si i thojnë, kur derdhet ngjyra dhe e lë më rrjedhë dhe intervenon pak.

Piktura me *drip*. Pra, Antoni ka eksperimentu pak edhe me stile të ndryshme të pikturës?

Po. Kur unë kam qenë student ai ka dhënë Teknologji të Artit n'Fakultet te Arteve. Aty prej tij kemi mësu si përgatitet pëlhura, teknologji të pikturës, si përfitohet ngjyra e bardhë... Ose naj ngjyrë tjetër sipas pigmentit që



e ke. Ato i kemi mësu me té. Ndërkohë ai edhe ka pikturu. Por interesant, ai ka qenë profesor i teknologjisë, po kur i kornizojke ato piktura, u dredhavshin edhe Galeria i ka qitë n'koleksion, ato n'atë gjendje hala {qesh}.

Çka me të tregu tjetër per Antonin? Ai... mu martu s'është martu kurrë. Por avanturist ka qenë, pak a shumë {qesh}.

Kurrë s'e harroj njiherë– kjo është në '89-ën më duket. Unë me nji shok t'Pejës u nisëm per me shku n'Llozanë t'Zvicrës, se edhe aty ka pasë portrete me bo a din? Tu e pasë krejt Adriatikun, hupëm, aventurë bonëm, sillu pështillu, u kthymë apet n'Dubrovnik, edhe kur u kthymë Antoni ka qenë me nji specializim në Romë për teknologji diçka, për konzervim. Edhe na pa. "Qe," tha, "5,000 dinarë," se na metëm, s'na delshin [paratë] për bileta me u kthy n'Prishtinë. E na i dha, tha "Se jam kthy prej Romës..."

Pastaj Anton Gllasniqi, ka vazhdu e ka ndërru stilin. Kronologjikisht, kur flasim, a ka shku prej abstraktes në ndonjë formë tjetër?

Ma abstrakte jonë [pikturat në Galeri] se këto ma vonë qe i ka punu. Ai s'ka pasë stil konkret apo... Krejt çka i ka pasë, t'tregova më herët, n'pjesën e vonshme i ka pasë ato ngjyra, i ka shfrytëzu se kom bisedu me to, ai u mundojke me lidhë edhe me religjion... Antoni po ashtu i ka pasë shumë punime në Fakultet të Arkitekturës, me nji hapësirë, [aty ka pasë] edhe punime t'tjerëve po edhe t'tij.

A ka qenë si depo?

Qaty dikund një klasë, pas luftës, ma vonë çka kanë bo nuk e di... Madje një koleg...[pas luftës] i kish thonë Antonit me ardhë tek Maxi tash, ateherë ka qenë Restaurant Beogradi përballë Kino ABC-së. Aty kanë qenë "Shqiponjat,".... kastraveca, bandita. [Ai kolegu i përbashkët] i ka thënë [Antonit], me ardhë aty.

Edhe tu shku n'shpi e kom taku te kafiqat, aty te "Gjani" a din? Roku, i djali atij Gjonit doktorit, Zef Gjonit, e

ka pasë ni kafiq. E para [kafiqit] po pres, kur po e shoh, del Toni. “Oh ku je?”, tha “Kqyre bre, mka thirrë nesër” e i bijke e diele, “Nesër me ardhë aty mu paraqitë.” “Kush bre t’ka thonë?” Ia kish harru emrin. E i thashë, “Toni bre, mos ta nin, bile mos gabo, me shku aty.”

Mas do vjete erdh Antoni prapë këtu. Unë i shoqëroj, i takova ketë Antonin me këta kolegët tjerë, me Shyqri Nimanin, e valla këtu, bile do foto i kemi tu bisedu. Ai s’ka qenë tip që ka bo dëm diçka. Dy banesa i ka bo, i ka pasë, njanën e ka shitë pas luftës se e fitoi, ajo ishte politike atëherë, ai u shkru kroat, se nanën kroate. Tash te Leo ngjitun ka qenë. Mandej shkoi n’Zagreb, moti e ka pasë banesën atje. Po qashtu… beqar tanë kohë, adventurist.

Edhe ai Musllim Mulliqi edhe Nysret Salihamixhiqi, n’vitet e ‘70-ta, ‘80-ta, nonstop kanë pi te Llausha. Gjithnji bashkë kanë qenë.

Këta tre?

Mm {pohon}. E tash këta dy [Antoni dhe Nysreti] si t’njejtë… M’i pa, a din? E Muslimi, kur pijshin, i shtijke mu përla. Ai ja u shtijke xekrën pak mandej ata u përlajshin, herë shqip, herë serbisht, herë boshnjakisht {qesh}. Eh…

Na qe i kemi shiku katalogjet, s’kemi arritë me gjetë shumë informata për ekspozita. Vërehej që ka marrë pjesë nëpër ekspozita grupore, po pastaj është një periudhë e gjatë kur nuk përmendet. A mos e dini nëse ka pasë Antoni ndonjë ekspozitë personale?

Valla s’më kujtohet…jo. Me marrë pjesë në të gjitha ka marrë pjesë, por personale asnjëherë. S’e maj n’mend. Muj me t’rrejtë.

Pastaj nuk permendët ma, nji kohë Antoni, n’qato vitet e 90-a 2000-a nuk ka kurrfarë informate per të. E për tjerët ka pasë.

Se s’ka marrë pjesë më.



# Hilmija Ćatović





# ESHTË MËKAT QË VEPRAT E KOSOVA RËVE NUK PREZENTOHEN NË EVROPË

## Ibrahim Kodra mbi veprat e artistëve figurativ të Kosovës

*Kosova, për mua, është një zbulim i madh në lëmin e ar tit figurativ dhe të artit në përgjithësi. Këtë e kam ndje rë më së miri duke i parë veprat dhe duke shkëmbyer mendime me artistët figura tivë, gjithashtu edhe me letra rët. Shkurt, këtu janë bërë përparime të dukshme.*

*Sipas rezultateve të tanish me, veprat e artistëve kosova rë janë të denja për t'u pre zentuar në botën e jashtme dhe, kujtoj, është mëkat i madh që veprimtaria artisti ke e kosovarëve nuk del pa ra opinionit evropian. Meqë, pos kualiteteve të tjera arti stike, si kualitet i posaçëm është fakti se krijuesit e kë saj treve janë në vlug të rry mave bashkëkohëse të artit.*

*Ja, për shembëll, në kolori tin e* **Muslim Mulliqit** *ngjy ra nuk është vetëm një thën je e thjeshtë, por është edhe një shqetësim që qarkullon si gjaku në damarë. Kështu, Mulliqi shpreh jo vetëm shqe tësimet e veta personale, por edhe të njeriut të shekullit tonë. Piktura e tij e bazuar në realizmin ekspresionist ka dhënë si rezultat forma më të persosura në shtjellimin e ek zistimit të figurave. Dhe pi kërisht këtu qëndron kualiteti më i madh i kësaj tendence. Kurse* **Gjelosh Gjokaj** *me shp rehjen sureale abstrakte arrin të stabilizojë vlera më har- monike me të cilat shpreh pa qen dhe dinamikën e botës. Duke e gërshetuar pikturën me ca elemente grafike arriti të jetë në lartësinë e rezulta teve më të përsosura të kësaj teorie. Ndërkaq,* **Svetomir Ar- siq,** *duke u mbështetur në pë rbërjen e tij në lëmin e sku lpturës, ka krijuar baza stabi le dhe me vetëdije ruan har moninë e bloqeve në kontras te të një niveli të lartë dhe monumental.*



**Tahir Emra: Mot i lig**

**Tahir Emra,** *mbështetur në përvojën e një pikture ekspre sioniste, ka kthjelluar ngjy rën dhe formën. Sot po, kri jon objekte dhe figurime du ke ju drejtuar botës me një gjuhë artistike të thjeshtë, për ta ngjeshur me filozofi.*

**Engjëll Berisha** *duke kalu ar nga përvoja metafizike ka arritur gjer në shprehjen e një bote të simbolizuar për mes formave të ndryshme gjeometrike, që kanë për që llim të shprehin ekzistencen e objektit në hovin e industri alizimit.*

**Nusret Salihamixhiq** *në su- realizimin e tij specifik ka thjeshtësuar tematikën e vet duke precizuar gjithnjë e më shumë elementet më rrënjë në folklorin tonë, duke ju dhë në kështu një kuptim më të gartë e më të gjerë veprave të veta, në të cilat flitet për botën e sotme.*

**Hilmi Qatoviq** *përdor ngjy- ra që kanë burimin në perë ndimin dhe në agimin e die llit në Kosovë. Me një mjesh tëri të dalluar ka evituar rre zikun e një neoromantizmi. Zhvillimi i sipërfaqeve piktu rale ka dhënë rezultate inte resante.*

**Rexhep Feri,** *gjatë këtyre dy viteve të fundit ka kthje lluar shumë elementa figura tive në veprën e tij duke për sosur kështu posaçërisht har moninë e ngjyrave dhe të tra jtave, të cilat sot paraqesin shprehjen më të lirë të kom pozicionit.*

*Përsa i përket artit aplika tiv, është e domosdoshme të theksohet në radhë të parë* **Shyqri Nimani.** *Para ca ko- hësh pashë në Beograd një libër të poezisë japoneze Ha iku, tendencë poetike e she kullit XVII, e cila ka për që llim të vlerësojë ndërgjegjen e njeriut në relacionin me botën e jashtme. Kjo zgjidh je grafike artistike e këtij libri nga Shyqriu mund të pa raqitet me kryelartësi në ek spozitat e librave kudo në Evropë.*

*Pos këtyre artistëve figura tivë që i përmenda, janë edhe artistët e tjerë nga radha e të rinjve, të cilët po kërkojnë shprehjet e tyre personale dhe të cilët që tani janë duke dhënë rezultate të dukshme.*

*Ibrahim KODRA*

## ENGJËLL BERISHA NË „MEMORIALIN E GJA SHTË TË NADEZHDA PE TROVIQIT" NË ÇAÇAK

Piktori kosovar Engjëll Berisha do të marrë pjesë në „Memorialin e gjashtë të Nadezhda Petroviqit" në Çaçak, me një punim të ve- tin. Në këtë ekspozitë e ci- la hapet më 6 shtator të kë- tij viti në Çaçak, punimet do t'i ekspozojnë 26 piktorë të njohur nga Jugosllavia dhe Franca, e ndër ta edhe Gerard Masabo, Zhag Vimad Maksim Sedei nga Parisi. Ekspozita do të hapet në sallën solemne të Kuvendit të komunës në Çaçak.

1-IX-70 R.

(J.)

GALERIA E VOGËL

# LËVIZJA NË UNAZË



*Piktori Hilmi Qatoviqi kompozoi aktet në hapësirën e unazës, në raporte fakturale të dritëhijes, disa në lëvizje e disa në pozita statike. Tërë ngjarja shtjellohet mbren dapërmbrenda unazës, që shëmbëllën me dritaren. Kjo dritare e dritës, nëpër të cilën përbirohen njerëzit dhe kërkojnë identitetin, simbolizon lëvizjen e gjërave që hyjnë në unazë e dalin nga andej. Kjo ide e piktorit Qatoviq realizohet me ndjesi sensibile për harmonizimin baraspeshues të ritmit dhe statikës, të dritës dhe hijes, të formës dhe hapësirës. Aktet e femrave të kompozuara në mes të unazës, me duar të ngritura sikur thërrasin dikë, dhe këtu, në këtë ide të piktorit çilet hapësira e sugjerimit të lëvizjes së jetës në kundërthënie dialektike lëvizje- statikë. Piktori fillon nga ideja shumë e qartë duke prekur sfera të hapësirës së filozofisë ekzistencialiste dhe, duke respektuar parimet e përgjithshme estetike të harmonizimit të elementeve figurative, krijon kompozimin rrethor në trajtë të unazës. Simboli unaza dhe simboli levizje në hapësirën e saj krijojnë boshtin e porosisë artistike te veprës, e cila transponohet në trajtë bashkëkohëse dhe mjaft sugjestive. Levizja e figurave, këtu akteve të femrave, në unazë është lëvizje e jetës, hapësires, trajtës, valerit dhe këtu, ne këtë ide estetike sheshohet çështja e ekzistimit të njeriut vetëm në procesin e lëvizjës së gjërave, që përbirohen nëpër unazë, apo nëpër rrethin e pafundësisë së lëvizjes dhe statikës. Vepër e krijuar me përkushtim dhe njohuri profesionale, e angazhuar dhe bashkëkohëse.*

***Nebih MURIQI***

18-04-81



ME RASTIN E EKSPOZITËS VJETORE TË KRIJUESVE FIGURATIVË TË PRISHTINËS

# SPEKTËR I GJERË INTERESIMESH

**Ekspozita kolektive e anëtarëve të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Prishtinës në Galerinë e Arteve tuboi më shumë se 40 krijues në teknika të ndryshme: skulpturë, pikturë, grafikë, vizatim e tapiseri. Duhet thënë se kjo ekspozitë është më kualitative se ajo e vjeme, po ashtu sivjet përgatitja është më e përkushtueshme dhe ka nxitur krijuesit e rinj të marrin pjesë me ambicje më të theksuar.**

Në tërësi, autorët në këtë ekspozitë realizojnë tema të ndryshme nga jeta jonë, me zgjidhje origjinale, plastike e shumë herë interesante. Vërehet mirëfilli se autorët me vullnet dhe emocion, me përkushtim e ngrohtësi, me kreativitet i nënshtrohen temës, ashtu edhe idesë, duke bërë punime që flasin për një kohë, me dëshira për ngritje më lart të zhvillimit të krijimtarisë figurative te ne. Pa marrë parasysh se cilës gjeneratë i takon, secili autor përkrah, përqafon ato ecuri të krijimtarisë së lirë në kuadrin e ekspresionizimit, në radhë të parë, me disa veçori automatike që theksojnë atmosferën, ngrohtësinë, begatinë krijuese të ambientit tonë.

Kështu, disa nga punimet evokojnë të kaluarën e idhtë me peripeci të shumta. Autorët e kësaj ekspozite me tablotë e tyre pikturale, në punimet e gdhendura në dru, në grafika e vizatime, secili në mënyrë të vet, me instiktin e tyre të brendshëm, përpiqen që artistikisht të gjejnë atë formë, ngjyrë, dhe atë që duhet të shprehë botën e krijuesit të mobilizuar dhe të përqëndruar që sa më me forcë e ekpresion të trajtojnë probleme kyçe të jetës bashkëkohëse dhe të së kaluarës. Punimet e shumicës së autorëve janë dokumente e dëshmi në gjurmimin e thellimin e rrugëve të krijimtarisë figurative në KSA të Kosovës. Për këtë flasin disa punime, që janë plot ngjyrë lirike, të realizuara me mjete ekspresive e mjaft shprehëse. Po ashtu ka mjaft nota të lirizmit freskues, që tregojnë për optimizmin e autorëve që mund të krijojnë ashtu si ia impunon pulsi e instikti i brendshëm.

Ekspozita sjell edhe larmi kompozicionale. Edhe kësaj here dominojnë tablotë në pikturë, pastaj kemi me radhë punimet në teknikën e grafikës, e në fund, në skulpturë. Teknikat e tjera janë

mit. Autorët e tjerë që prezentohen këtu janë në nivelin e krijimeve të deritashme, si: Nysret Salihamixhiqi, Rexhep Ferri, Kadrush Rama, Engjëll Berisha. Disa kanë punime në stilin pop-art-teknikë që nuk është preokupim themelor, siç është rasti i Xhevdet Xhafës. Hilmi Qatoviqi tregon një ngecje dhe aprovim të ndikimit të dukshëm të piktorëve të tjerë. Edhe disa të tjerë (nga radhët e të rinjëve), ende nuk mund t'i shmangen ndikimeve. Vërehet ndikimi i Muslim Mulliqit te disa autorë në këtë ekspozitë. Nga punimet e të rinjve veçojmë punimet e Avni Toplices, Sami Bicajt dhe Bislim Aliut. Jonuz Haradinaj tenton që ajo që është racionale dhe poetike të jetë në funksion të skenjës asociative, herë-herë abstrakte. Zoran Jovanoviqi, edhe pse merret me grafikë, me dy piktura tregoi se ka një diapazon të gjerë të interesimeve. Madje, dy punimet janë interesante me theksim të një note lirike, edhe pse kalon në ujërat e ilustrimit dhe të theksimit stereotipik.

Nga autorët me punime në grafikë veçojmë Ymer Shaqirin, Agim Salihun dhe Shaip Çitakun, të tretë i drejtohen kohës, njeriut, ambientit. Shaip Çitaku gjeometrizmin e ka bazë për projeksionet e veta krijuese. Agim Salihu paraqet tablo me insistim në sfondin e zi, në hapësira metafizike, në autopomorfizëm. Ymer Shaqiri insiston në detaje edhe në hapësira më të gjëra. Temat janë të lidhura me hapësirat arkitektonike në të cilit i gjen elementet evokuese, lirike Hysni Krasniqi. Nga punimet në vizatim veçuam atë të Veli Blakqorit. Aty dallojmë linjën, që në strukturë dhe në rrjedhë ka spontanitetin, veprimin sugjestiv, ngërthyes. Linja shpreh një ndjesi specifike që lë mbresë lakmuese.

Në punimet skulpturale dallohet Ismail Qosai Busti i

RILINDJA E hënë, 6. XII. 1982

## Hilmija Ćatović:
## Siç e kujton i biri

I biri i Hilmija Ćatović, Ervini, është piktor dhe profesor i artit në Universitetin e Prishtinës në Mitrovicën e Veriut. Gjatë një bisede telefonike në gjuhën angleze, ku në përkthim ndihmonte edhe e bija e tij Hana, ai na tregoi për rëndësinë e veprës së babait të tij si një ndër piktorët e parë akademikë të Kosovës. Ervini, i cili kishte lindur dhe ishte rritur në Prishtinë, kujton me pikëllim zhvendosjen e tyre në Novi Pazar dhe në veçanti humbjen e 156 pikturave të babait të tij, të vjedhura nga atelieja. Siç rrëfen ai, pas luftës shtëpia e tyre dhe atelieja ishin uzurpuar nga njerëz të panjofshëm, siç edhe ishin uzurpuar shumë banesa e shtëpi të serbëve në atë kohë. Familja s'ka arritur t'i kthejë pikturat që nga atëherë.

Nga hulumtimi që kemi bërë në Galeri, kemi parë që babai juaj, Hilmija Ćatović ka qenë shumë prolifik, si duket sidomos gjatë viteve të '70-ta e '80-ta. Po ashtu kemi zbuluar që ka qenë njëri nga piktorët akademikë të parë në Kosovë. Por ne s'kemi dëgjuar shumë për të më herët, po supozojmë për shkak ndasive politike. A mund të na tregoni më shumë për të?

> Para gjashtë viteve, një ekip televiziv nga Mali i Zi, nga Podgorica erdhën në Novi Pazar —sepse babai im ka vdekë atje—në shtëpinë time. Ata dëshironin të bënin një film të shkurtër për babanë tim. Më herët e patën bërë edhe një film tjetër, ndoshta para dhjetë viteve, por tani pasi që vdiq ai, dëshironin të bënin një film më të gjatë. Dhe pasi që ishin në Novi Pazar, në Podgoricë, ata shkuan në Prishtinë tek Akademia e Arteve, po askush nuk kishte pranuar të fliste për babanë tim. Për mua kjo është shumë, shumë e pikëllueshme.
>
> Çfarë dua të them është se babai im kishte shkuar në Prishtinë rreth viteve të '50-ta të shekullit të kaluar. Ai së pari ka punuar në Rilindje, si dizajner grafik dhe pastaj ka qenë një nga profesorët kryesor në Shkollën e Lartë

Pedagogjike. Ai dhe Muslim Mulliqi, Tahir Emra, Gjelosh Gjokaj dhe Sveta Arsić-Basara, skulptori serb, kanë qenë profesorët e parë në atë periudhë.

Pas tyre e di që ka qenë edhe Ferri, Rexhep Ferri, dhe pas tij shumë e shumë të tjerë.

Pra babai im ka qenë në gjeneratën e parë të piktorëve [të Kosovës], dhe ka qenë një piktor shumë i rëndësishëm ish-jugosllav.

Për mua është kënaqësi të flas me ju sepse unë kam lindur në Prishtinë. Unë jam një djalë i ri i Prishtinës. Kam jetuar aty 33 vite, dhe pas luftës kam ardhë në Novi Pazar sepse gruaja ime jetonte aty. Dhe pas asaj, ura u thye, dhe tash unë jetoj aty. Por jam i mallëngjyer sepse krejt jetën time e kam kaluar në Kosovë, në Prishtinë.

A mund të ndani me ne informata të përgjithshme mbi jetën e tij? Sepse një gjë e kemi vërejtë në katalogje dhe publikime të ndryshme, edhe vendlindja e tij ndryshon.

Po është normale për këtë periudhë…E vërteta është që babai im ka lindë në Shkup në vitin 1933, sepse babai i tij ka qenë arsimtar në shkollën e mesme myslimane në Shkup. Pra gjyshi im ka qenë arsimtar në medresë. Pas vdekjes së gjyshit, ai ka vdekë shumë i ri, familja shkojnë në veri të Malit të Zi, në Rozhajë, ku edhe jetojnë. Atje babai im Hilmija shkon në shkollë të mesme, dhe pastaj në shkollë të artit në Herceg Novi. Ka qenë shkollë e famshme atëherë në Jugosllavi. Ai ka qenë në të njëjtën klase me Dado Djurić, me Vojo Stanić, me piktorë shumë të famshëm. Pastaj me Nikola Guzdenović— edhe ai ka qenë profesor në Akademi në Prishtinë. Nikola Guzdenović - Gozdo.

Dhe pas Herceg Novit, babai im ka shkuar në Shkup në klasën e Lazar Licenoskit, piktor shumë i famshëm i asaj periudhe në Shkup. Prej aty ai shkon të studiojë në Beograd. Pas Beogradit, e ftojnë të shkojë në Prishtinë si dizajner grafik dhe ilustrator në Rilindje, dhe më pastaj në gazetën Jedinstvo. Pastaj në vitin 1958 është bërë profesor, filloi të ligjëronte në Shkollën e Lartë Pedagogjike.



E pas asaj, dikur në vitin 1971 e themeluan Universitetin e Prishtinës dhe në vitin 1974 e themelojnë edhe Akademinë e Arteve, Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Profesorët e parë të pikturës kanë qenë Hilmija dhe Muslim Mulliqi, dhe Tahir Emra. Grafikë në atë periudhë ka dhënë Gjelosh Gjokaj, ndërsa skulpturë Sveta Arsić, dhe më pastaj ka qenë skulptori shumë, shumë i famshëm, shqiptar Agim Çavdarbasha. Profesori im, Agim Çavdarbasha.

Më vonë pastaj ka ardhë në grafikë Agim Salihu, në fakt para tij ishte Rexhep Ferri, Gjelosh Gjokaj e përmenda, si dhe Nebih Muriqi ka qenë profesor i vizatimit, ai ka qenë profesori im i vizatimit, edhe Xhafa, po Xhevdet Xhafa ka qenë profesor i grafikës.

Më kujtohen sepse edhe para se të isha student, si djalë i vogël, kam shkuar ta vizitoja akademinë {qesh}. Shoku im dhe i biri i piktorit të famshëm, Muslim Mulliqit, Visar Mulliqi, besoj e di këtë. E di atë periudhë se ne bashkë i kemi kaluar ditët e fëmijërisë, në akademi e më pastaj ishim edhe studentë bashkë…

Pra, edhe ju keni studiuar në Prishtinë apo jo?

Po, po kam studiuar në Prishtinë. I kam kryer studimet në vitin 1990, para luftës në Jugosllavi. Në vitin 1990 e kam filluar magjistraturën, dhe e kam përfunduar në vitin 1993. Pas kësaj, lufta filloi, në Kroaci, në Slloveni, Bosnjë, dhe më vonë edhe në Kosovë, dhe pastaj e dini edhe ju vet çfarë ka ndodhë pas asaj.

Është interesante që Ćatovići ka ardhë në Prishtinë për të punuar në Rilindje. Kemi gjetur edhe ilustrimet e tij të librave për fëmijë. Nuk e di nëse e keni parasysh, e kemi gjetë një libër të Mark Kaqinarit me këngë për fëmijë të cilën e ka ilustruar ai. A ka punuar shumë si ilustrator fillimisht, apo gjithnjë ka qenë edhe duke pikturuar?

Hilmija Ćatović është një piktor shumë universal sepse ka studiuar në Akademinë e Arteve të Aplikuara në Beograd. Pra ka qenë ndër-disiplinor. Babai im ka qenë edhe piktor,

edhe ilustrator, edhe ka bërë mozaikë, edhe skenograf, dhe ka bërë shumë e shumë gjëra të tjera. Kjo ka qenë mënyra si është edukuar. Babai im ka qenë një nga studentët e parë që kanë kryer këtë shkollë në Beograd, dhe pastaj i ka bërë edhe studimet pas-universitare. Kështu që kur ka ardhë në Prishtinë ai ka ligjëruar, ka vizatuar, pikturuar dhe madje ka punuar edhe në revistën Pionieri, gazetën Rilindja. Ka punuar për Teatrin Popullor [Teatrin Kombëtar] si skenograf, dhe ka dizajnuar shumë emblema në atë periudhë. Pra ka bërë gjëra në praktika të ndryshme. Tash kësaj ne në akademi i themi dizajn utilitar. Pra ai ka qenë i zhdërvjelltë në shumë praktika, në dizajn, grafikë, dhe pikturë.

Kur erdhi në Prishtinë, a kishte familje këtu apo erdhi vetëm për punë? A u zhvendos e gjithë familja e tij?

Ai erdhi me nënën time. Nëna ime ishte nga Kroacia, nga Dalmacia…ajo ka qenë një nga arsimtaret më të vjetra të gjuhës kroate në Kosovë. Dhe në 1966 linda unë në Kosovë, dhe pas disa viteve, në vitin 1971, lindi vëllau im Daria.

Po, ai erdhi vetëm për punë! Ajo ishte arsyeja kryesore, por atij edhe i kanë pëlqyer njerëzit në Kosovë sepse në këtë periudhë në Kosovë ka pasë shumë njerëz të ndryshëm: shqiptarë, turq, serbë, malazezë…Nga të gjitha pjesët e Jugosllavisë kanë ardhë shumë njerëz të kualifikuar në Prishtinë sepse ajo po bëhej një nga qendrat e Jugosllavisë. E di, çdo ditë Prishtina po bëhej më e madhe, e më e madhe… kështu që për disa vite Prishtina u rrit, u rrit shumë.

Fascinuese. A dini më shumë për fazën kur babai juaj ishte duke studiuar në Beograd?

Babai ishte student në Akademinë në Beograd pas Luftës së Dytë Botërore. Ka qenë shumë vështirë atje, ishin kohëra të vështira, vite të varfëra…Njerëzit ishin të uritur. Hilmija, babai im, e di se fliste për këtë periudhë – edhe për të kishin qenë vite të vështira. Megjithatë studentët vazhdonin të punonin, të bënin punë shumë mbresëlënëse…pra ka pasë



shumë entuziazëm dhe energji. Ai vet ka qenë i përsosur në klasë, dhe profesorët e tij, të cilët tash natyrisht krejt kanë vdekur, kanë thënë më herët se ka qenë shumë i angazhuar, shumë punëtor.

Kur e ka përfunduar, ai ishte studenti më i mirë i vitit. Dhe pasi që e kishte përfunduar s'kishte ditur çka të bënte. Dhe dikush i ka thënë, më duket se ka qenë shkrimtari Esad Mekuli, po ashtu më duket se ka qenë, i ka thënë "Pse nuk po vjen në Prishtinë? Prishtina është tash qytet i vogël dhe i ri, por Prishtina do të bëhet çdo vit më e madhe." Dhe babai im i është përgjigjur, "Pse jo? Okej."

Kur ka arritë në Prishtinë, në atë periudhë kanë qenë në pushtet Fadil Hoxha dhe Mahmut Bakalli [udhëheqës të Lidhjes Komuniste të Kosovës], dhe i kanë thënë babait tim, "Duhesh me ndejtë në Prishtinë dhe të bësh familje këtu, dhe së shpejti ne do ta hapim shkollën e lartë, e pastaj universitetin." Dhe babai im i ka dëgjuar këto, dhe i ka besuar atyre, dhe ka besuar në këtë ardhmëri dhe ka qëndruar në Prishtinë për gati 40 vite. Po, 40 vite.

Në vitin 1999, pas luftës, ai shkon në Mal të Zi për t'i kaluar pushimet verore, pas bombardimeve, pas luftës së vështirë. Kështu që ai ka thënë "Të shkojmë," se e kemi një vilë të vogël në Rozhajë, një qytet i vogël. Në fakt Rozhaja është e famshme se shumë njerëz nga Gjakova dhe Peja kanë qenë refugjatë gjatë luftës në Rozhajë, dhe është një vend mjaft i popullarizuar në veri të Malit të Zi. Dhe kështu, ne kemi një shtëpi të vogël atje dhe babai im pat thënë, "Të shkojmë t'i kalojmë pushimet verore dhe pastaj mund të kthehemi në Prishtinë." Por, dhe është e vështirë të them se sa njerëz, por dikush kishte hyrë me dhunë në shtëpinë tonë në Prishtinë, dhe pas asaj ne më s'jemi kthyer në Prishtinë.

Dikush iu ka uzurpuar shtëpinë, apo dikush iu ka vjedhur gjësendet?

Po, na kanë uzurpuar shtëpinë, po. Dhe në atelenë e babait tim, rreth 156 piktura–piktura shumë të vjetra– janë vjedhur. Janë vjedhë pikturat e asaj periudhe. Dhe kjo është gjë tepër pikëlluese, zhgënjyese. Pas kësaj babai im ka qenë i

dëshpëruar…ai ka vdekur para gjashtë viteve [në vitin 2017]. Dhe më pat thënë, “Ervin, unë kam kaq shumë studentë, shqiptarë, turqë, serbë, malazezë,” sepse në ato vitet ne kemi qenë së bashku, i kemi dëgjuar ligjëratat së bashku, kemi studiuar së bashku. Nuk ka qenë thua se studimet në sërbisht dhe shqip kanë qenë ndryshe, jo në fakt kanë qenë të njëjta. Në Akademi ne kemi qenë bashkë, bashkë, bashkë në arsim. Arsimi ka qenë bashkë, por ama vetëm në akademi[në e arteve], sepse në fakultetet tjera, në juridik apo në fakultetet teknike, ligjëratat në sërbisht e shqip kanë qenë të ndara. Po në Akademi, kemi studiuar dhe kemi ndejtë bashkë, a din? Për shkak se në Akademi Vincent van Gogh është njëjtë, si për mua ose si për dikë nga Serbia, apo si për shqiptarët. Na thonim, në akademi Chopin-i është njëlloj për secilin…dhe kjo ka të bëjë tepër me politikë, një politikë vërtet të prishur. Një urë e shembur…sepse unë mendoj që sportisti, apo artisti është ai që ndërton ura mes njerëzve. Ndersa politika e shembi atë urë.

U befasova nga kjo. Jam duke e thjeshtëzuar, sepse ndoshta jam më e re dhe nuk i di detajet nga vitet e ‘90-ta, por kam besuar ngase ju dhe babai i juaj jeni boshnjakë, nuk e kuptoja pse kishte ndasi politike. A ka qenë sepse ka vazhduar të punojë si profesor në akademi gjatë viteve të ‘90-ta kur shqiptarët s’kanë qenë në universitet?

Po, po . Mendoj që në ‘91, ose ‘92, u thyen…Profesorët shqiptarë nuk punonin më në universitet, por une isha duke folur për vitet e mëparshme, kur unë kam qenë student.

E kuptoj.

Nuk më pëlqen politika. S’më pëlqen hiç asgjë nga politika. Dhe s’më ka marrë mendja kurrë që do të fillonte lufta në Bosnjë dhe Kosovë. Sepse a s’mendojmë që është më mirë të jetojmë në një qytet multikulturor, multi-etnik. është më mirë, si në Evropë, si në krejt botën, apo jo? Dhe pastaj unë jam lindë në një qytet të tillë, dhe une s’kam menduar që do të ketë ndonjëherë luftë në Prishtinë apo në Sarajevë.



Dhe nuk e di se si ndodhi. Ka qenë projekt i asaj kohe, i shumë politikanëve. Nuk e di. Dhe jam budalla sa i përket politikës. Më besoni, jam shumë budalla dhe nuk dua të flas për politikë. Dua të flas vetëm për artin, civilizimin njerëzor, estetikën e kulturën. Ky është vendi im.

Ju kuptoj. Po ju pyes ngase e përmendët që pikturat janë vjedhur. A keni arritur të ktheni banesën, shtëpinë tuaj në Kosovë, apo s’e keni më?

Kam provuar të kthehem dhe t’i gjej, shumë prej pikturave të babait tim. Kur babai im ishte shumë i vjetër dhe i sëmurë, më pat thënë, “Ervin s’është me rëndësi. Aq shumë piktura më kanë mbetë në Prishtinë. Po ma mire që të jenë dikah, në ndonjë shtëpi apo në ndonjë institucion.” Më pat thënë, “Veç s’dua që t’jenë të shkatërruara….Veç s’dua të jenë të shkatërruara.” Në atë periudhë shumë piktura patën mbetë nëpër institucione, nëpër koleksione private, dhe dikush ka hy me dhunë në atele dhe i ka marrë 156 piktura. Dhe kurrë nuk i kemi gjetur. Nganjëherë dua të vi dhe të shoh se ku mund të jenë, por kaq shumë vite kanë kaluar dhe s’besoj që ka mbetë ndonjë gjë.

Por s’është me rëndësi - arti jeton. Nuk është me rëndësi, arti mbetet i gjallë.

Edhe në Galeri, ai ka qenë në ekipin e artistëve — Këshillin Artistik. Në atë periudhë ne kemi tentuar të bëjmë një Koleksion të shumë piktorëve të Kosovës. Dhe nuk e di pas asaj, a janë ato piktura ende aty [në Galeri].

Dua të them edhe diçka. Shumë vite më vonë, isha në Slloveni, e Kroaci. Sot jam piktor i famshëm. Kam pasë ekspozita në Gjermani, Itali, Francë, shumë njerëz më ftojnë. Arti në Kosovë është shumë i veçantë, sidomos në ato vite. Sidomos në vitet ‘60, ‘70, dhe ‘80, pra para luftës.

Fillimi i artit në Kosovë, e di se ende arti në Kosovë është i mirë, madje jam i sigurtë që është shumë më i mirë. Shumë prej kolegëve të mi [të studimeve] punojnë sot. I ndjeki, dhe e shoh se janë artista të mirë, edhe pse nuk jemi në kontakt. Por po flas tani për periudhën e babait tim— kjo ka qenë një periudhë e veçantë për Jugosllavinë. Dhe

njerëzit në Beograd, Zagreb, e kudo, më thonë, Prishtina ka qenë qendër e artit në jugun e Jugosllavisë - një qendër shumë e veçantë arti. Dhe më besoni është kënaqësi ta dëgjosh këto, e kam përjetuar shumë pozitivisht. Përshtypja për artin e Kosovës është shumë pozitive.

Pse mendoni që ekziston kjo përshtypje dhe si ka ndodhë? Prishtina në atë kohë ishte e vogël, jo shumë e zhvilluar. Akademia sapo ishte hapur. Si mendoni që ka ndodhë?

Prishtina filloi të zhvillohej në vitet e '60-ta. Shumë studentë shkuan në Zagreb, Ljubljanë, dhe Beograd, e pastaj u kthyen të punonin në Prishtinë. Bashkë me vete ata sollën në Prishtinë diçka të veçantë, secili prej tyre kishte sjellë tipe të ndryshmë të punës, veçori nga Zagrebi, apo edhe vende tjera. Dhe unë mendoj se një piktor nga Kosova e ka njëfarë energjie të veçantë...Kanë diçka që të tjerët nuk e kanë. E kanë njëlloj temperamenti të pabesueshëm. Në këtë periudhë të artit jugosllav, artistët kosovarë ishin të dallueshëm dhe të dalluar.

Në këtë kohë, Akademia e Arteve të Prishtinës dhe piktorët e saj ishin artistë të famshëm nëpër Evropë – këtë e di.

Interesant. Duke i shikuar pikturat e Ćatovićit, po ashtu e kemi vërejtur se stili i tij nga vitet e '70-ta në ato të '80-ta ndryshon mjaft. Do të thoja ka faza të ndryshme të punës së tij. A mund të më tregoni më shumë për stilet që babai juaj ka zhvilluar gjatë karrierës së tij si piktor? Duke qenë që jeni piktor edhe vet besoj që keni një perspektivë më të kualifikuar për të komentuar këtë zhvillim.

Ndryshimet në stilin e tij janë shumë normale. Pas Luftës së Dytë Botërore, në '50-tat, '60-tat, po edhe '70-tat, mund të themi se kjo periudhë është dominuar nga tematikat sociale. Në ato vite, Kosova ka qenë e varfër dhe kjo ka dominuar në shumë tema...madje edhe në tematika të pikturës, dhe babai im kështu pikturonte këtë temë. Pikturonte pleq, njerëz të varfër, fshatarë...e kështu.



Pas asaj vazhdon periudha ku ka bërë peizazhe, dhe pas kësaj faze hyn në një faze ku merret me figuracion, njerëz në hapësirë...këto janë më moderne, abstrakte, art ekspresionist. Këto zhvillime janë normale, dhe besoj edhe në republikat tjera të Jugosllavisë ka ndodhë e njëjta. Por e di se të '70-tat, janë vite të rëndësishme për artin e Kosovës, ka qëne art vërtetë i veçantë dhë i rëndësishëm për Jugosllavi. Shumë i rëndësishëm, më besoni.

Ju e përmendët se babai i juaj ka qenë në ekipin e Galerisë, në Këshilin Artistik. A ka punuar ndonjëherë në Galeri?

Jo, ai ka punuar vetëm në universitet. Ky ekip, ka qenë si bord. Për shumë vitet babai im ka qenë presidenti i Shoqatës së Artistëve [Figurativ] të Kosovës. Edhe Muslim Mulliqi ka qenë president, edhe Nysret Salihamixhiqi.

Dhe çfarë ka ndodhë pasi që u zhvendosët në Novi Pazar? A vazhdoi babai juaj të ligjëronte dhe pikturonte?

Pas asaj, ka punuar vetëm edhe dy vite sepse në filim Akademia e Arteve ishte në Kruševac dhe pas asaj në veri të Kosovës, po babai im pat vendosë që dëshironte të dilte në pension. Nuk donte më të ishte në universitet se ishte plakë dhe në këto vite më thoshte, “Jam shumë plak për krejt çka më ka ndodhë dhe krejt çka dua është të shkoj në Malin tim të Zi dhe të pikturoj, sepse i kam humbë krejt pikturat.” “I kam humbë krejt pikturat dhe më duhet të filloj të punoj prapë.” Ishte lodhë.

A keni piktura nga kjo periudhë, pas zhvendosjes?

Po ka shumë piktura, edhepse u pat lodhë nga jeta ai donte të bënte sa më shumë piktura. Dhe punonte çdo ditë. Dhe më pat thënë, “Duhesh të punosh sepse vetëm një piktor i mirë është njeri i mirë. Dhe duhesh të jesh i mirë për të punuar, për të pikturuar, për t'i ekspozuar pikturat.” Kjo më kujtohet. Është e dhimbshme për mua, por është një mësim i mirë.

Hilmija Ćatović
*Biseda*, 1973
Vaj në pëlhurë
133 × 101 cm





Hilmija Ćatović
*Figura në peizazh*, 1976
Vaj në pëlhurë
102 × 102 cm



Hilmija Ćatović
*Forma* (p.d.)
Vaj në pëlhurë
123 × 86.5 cm



Hilmija Ćatović
*Loja* (p.d.)
Vaj në pëlhurë
180 × 120 cm



Hilmija Ćatović
*Peizazh*, 1972
Vaj në pëlhurë
164 × 102 cm



Hilmija Ćatović
*Peizazh*, 1997
Vaj në pëlhurë
140 × 140 cm



Hilmija Ćatović
*Pritja*, 1976
Vaj në pëlhurë
100 × 130 cm



Hilmija Ćatović
*Procep*, 1977
Vaj në pëlhurë
140 × 100 cm



Hilmija Ćatović
*Rrënjët* (p.d.)
Vaj në pëlhurë
65 × 65 cm



Hilmija Ćatović
*Sulë Hamalli*, 1976
Vaj në pëlhurë
102 × 102 cm



Hilmija Ćatović
*Sulë Hamalli*, 1972
Vaj në pëlhurë
100 × 130 cm

# Nimon Lokaj





Nimon Lokaj

Niman LOKAJ lindi më 7 Dhjetor 1941 në Pobërgjë afër Deçanit. Shkollen e Mesme të Artit e kreu në Pejë. U diplomua në Akademinë e Arteve Figurative (dega e pikturës) në Beograd, në klasën e profesorit Zoran Petroviq më 1969.
Është anëtarë i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës.
Jeton dhe punon në Deçan.

<u>Udhëtimet studimore</u>
Itali, Francë, Greqi, Shqipëri, Spanjë, BRSS, Poloni.

<u>Ekspozitat kolektive</u>
1970 - Tivarë, Muzeu i qytetit.
1970 - Titograd, Shtëpia e Armatës Popullore të Jugosllavisë.
1971 - Prishtinë, Fosjeu i Teatrit Popullor Krahinor.
1973 - Tivarë, Muzeu i qytetit.
1974 - Prishtinë, Foajeu i Teatrit Popullor Krahinor.
1976 - Ferizaj, Galeria "Zef Kolombi".
1981 - Tuzllë, Galeria e Portretit Jugosllav.
1990 - Prishtinë, Galeria e Arteve.

<u>Ekspozitat kolektive</u>

1973 - Prishtinë, Ekspozita vjetore e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, Foajeu i Teatrit Popullor të Krahinës
1974 - Prishtinë, Salloni I Pranveror i Kosovës, Foajeu i Teatrit Popullor Krahinor
1975 - Prishtinë, Bienali I i Vizatimit, Muezu i Kosovës
1976 - Prishtinë, Salloni II Pranveror i Kosovës, Foajeu i Teatrit Popullor Krahinor
1977 - Prishtinë, Bienali II i vizatimit, Foajeu i Teatrit Popullor Krahinor.
1977 - 20-vjetori i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, Galeria e Arteve
1977 - Prishtinë, Salloni IV Pranveror i Kosovës, Foajeu i Teatrit Popullor Krahinor
1978 - Prishtinë, Salloni V Pranveror i Kosovës, Foajeu i Teatrit Popullor Krahinor
1979 - Prishtinë, Bienali II i Vizatimit, Galeria e Pallatit të Rinisë "Boro-Ramizi"

- 3 -

Noman Lokaj krijimtarinë e vet figurative e fillon pas diplomimit në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd më 1969, kur ai i prezentohet publikut me skpozita të pavarura në Tivarë (197o), Tìtograd (197o), Prishtinë (1971), Tivarë (1973), Prishtinë (1974), Ferizaj (1976) dhe Tuzllë (1981). Ndërkaq, në ekspozita kolektive është i oranishëm gati në të gjitha manifestimet e Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, sidomos në "Bienalin e vizatimit" (I-VIII) dhe në "Sallonin Pranveror të Arteve Figurative dhe Aplikative të Kosovës" (I-XIII). Në këto ekspozita të pavarura dhe kolektive puna krijuese e tij është vlerësuar nga kritika dhe është pëlqye nga publiku.

Rruga krijuese njëzetvjeçare e këtij piktori është një dëshmi se ai është duke e kultivuar shprehjen artistike figurative dhe atë duke e ngritur gradualisht në një shkallë më të lartë si në pikëpamje të formës ashtu edhe të përmbajtjës. Pamjet e natyrës-peizazhit për N.Lokajn janë preokupim i përhershëm, ato në qasjet e tij figurative janë "therrë" e syrit dhe prodhim shpirtëror, sepse bukuria e trajtave natyrore e cila e rrethon piktorin është në funksion të ndjenjave, prandej artisti sikur dëshiron që refleksionin e kësaj bukurie natyrore ta shprehë në bukuri artistike përmes komponenteve dhe ligjeve figurative. Mbresat e tij nuk ~~jan~~ janë thjeshtë vetëm mbresa sa për të shënuar "një pikë", një pamje visore të fushës, malit, fshatit, qiellit etj., por ato janë më të thella, bazoheu në fuqinë e emocioneve dhe në "kornizen reale të observimit". Kështu, peizazhet e tij e fitojnë projektimin e çelsit të dritës dhe dimensionin estetik.

Kësaj rradhe piktori i prezentohet publikut me punime në teknikën e akuarelit. Këtë opus ai e ka realizuar përmes (në) tri cikleve: <u>Peizazhet e vendlindjes</u>, <u>Peizazhet e Kosovës</u> dhe <u>Ditari i natyrës</u>. Piktori në këto tri ci le të tija ka marrë në"shenim" realitetin objektiv, ambie tin ku jeton dhe vepron dhe atë e ka pasqyruar me ndieshmëri dhe artikulim. N.Lokaj sikur bënë "luftë" me format e ndara të natyrës të cilat ai në çdo pikturë (akuarel) të tij dëshiron t'i bashkon në një tërësi, ti materializon ato në strukturen e sipërfaqes së letrës me baraspeshë relative. Ndërkaq, format e veçanta artisti me sukses i ka sistematizuar në fishën e veriacioneve, në mënyrë të lirë e të figurshme, i ka lidhur dhe harmonizuar ato në planin e përspektivës me <u>shenjen e barazisë</u>. Të gjitha këto që i theksuam më lartë, piktori i ka arritur në tri momente kohore: në mëngjes, mesditë dhe në mbrëmje. Në këto intervale të kohës piktori e ka gjetur ndryshimin e trajtave, fuqinë e zbuluar të dridhjeve të dritës, kuptimin e thellësisës, pasurinë e nuansave të ngjyrës etj. Një gjë e tillë reflektohet edhe gjatë stinëve të motmotit. Kështu "kostumi i naytrës" në pranve rë, verë, vjeshtë dhe dimër piktorit i ka mundësuar

- 4 -

shprehjen më të plotë dhe më cilsore. Ndërrimi i stinëve ka ndikuar në disponimin e tij shpirtëror, që trajtave të natyrës, përmes lojës së dritë-hijës, planeve hapsinore dhe harmonisë së ngjyrave t'u jep formësim të dukur. Piktori në këtë rast nuk e përfillë "shkëlqimin e formës" dhe mashtrimin eventual të saj, por ndalet në ato pjesë, në ato përceptime të cilat atij i zgjojnë interesim të posaçëm për pasqyrim më të qartë. N.Lokaj gjatë hulumtimit të tij, ka zgjedhur ato trajta të peizazhit që në intervalet e kohës dhe në "plotësorin" e vendit kan ndikuar në boten intime të tij duke prekur në të njajtën kohë edhe në botën shpirtërore të shikuesve.

Duke e shikuar këtë ekspozitë mësojmë për zërin e natyrës të shprehur në art, mësojmë për realitetin objektiv të transponuar në realitet artistik dhe për shumë fshehtësi të tjera që janë të gërshetuara në një botë të cilën e shijojmë dhe e përjetojmë. Prandej, tingujt e natyrës të shprehur përmes komponimit figurativ me anë të brushës janë pjesë e pandarë e krijimeve artistike të këtij artisti. Veprat - peizazhet e tij nuk kanë shenja pikësimi, ato janë pasqyrime kohëzive të ambientit me veçoritë kryesore të botës së gjallë.

Rexhep Goçi


TELEVIZIONIT

**Niman Lokaj: «Spektri» (TVP - 21,40)**

tarisë së piktorit, Niman Lokaj.

Emisionin e përgatitën: Mustafë Xhemaili dhe Xhafer Krasniqi.

22,10 Gjatë ditës

22,20 Nesër në TV

Ril. 1-1-74

TAKIME

# I DASHURUAR NË BUKURITË E TREVAVE TË VENDLINDJES

■ **Nga biseda me piktorin akademik, Nimon Lokaj, profesor i Gjimnazit „Vëllezërit Frashëri" në Deçan**

Është gati e pabesueshme që në mesin e krijuesve dhe të konkurencës dinami ke kohore të shekullit tonë, të gjendet njeriu i qetë, krijues autentik me një gjuhë të pastër figurative që më brushën e tij përkdhel thesarin më të çmuar të shpirtit që e krijoi natyra. Ky është, pa dyshim, Nimon Lokaj, i cili nëpërmes ndjenjave dhe përjetimeve të tij në këtë moment na bëri të ndjejmë dhe të përjetojmë edhe ne. Nimoni, këtu na bën për vete, na i kujton bukuritë e trevës sonë, „pejsazhet e Kosovës", me një subtilitet dhe thuktësi koloristike me bashkëkohore, duke futur thellë në trajtimin e formës, ngjyrës, sipërfaqes, hapësirës dhe vijës, elemente të cilat e pasurojnë veprën pikturale dhe e bëjnë atë të pavdekshme.

Vlera artistike e veprave të piktorit akademik, Nimon Lokajt, qendron në një trajtim psiqik të motivit duke pasuruar me të gjitha elementet: kolorit tingëllues, kristalizimit struktural të formës, kompozicionit e të tjera.

Momentet psiqike dhe preokupimet më të cilat kacafytet Nimon Lokaj qenë bindëse në ekspozitat e tij personale në Tivat, Prishtinë dhe qendra të tjera. Ekspozitat e Nimonit çdo kund zgjuan interesim të madh të mija qytetarë në bregdet dhe Kosovë. Ai hapi ekspozitën edhe në vendlindjen e vet në Deçan dhe me veprat e veta la përshtypje të thella te bashkëvendasit e tij.

Nimon Lokaj rrjedh prej një familje të varfër fshatare. Ka lindur në fshatin Pobergjë, në komunën e Deçanit. Shkollën fillore e kreu në Deçan dhe Pejë. I dashuruar në art, i cili i ka flejtur në shpirt qysh prej fëmijënisë, u regjistrua dhe e kreu shkollën e artit në Pejë. Disa vite punoi si arsimtar i artit figurativ në Shkollën Fillore të fshatit Isniq të komunës së Deçanit e pastaj e kreu Akademinë e Arteve Figurative në Beograd. Nimoni, pasi e fitoi titullin e akademikut, mundi të inkuadrohet në Beograd dhe vise të tjera të vendit dhe Kosovës, por ai i qendroi besnik vendlindjes dhe kështu u kthye si profesor i artit figurativ në Gjimnazin „Vëllezërit Frashëri" në Deçan, ku punon edhe sot.

— Planet tuaja? — e pyetëm.

— Planet e një piktori janë të mëdha, por të lidhura ngusht me krijimtarinë figurative. Në të ardhmen e afërt — na informoi Nimoni, — do të paraqitem me ekspozitë personale para publikut të Beogradit, Sarajevës, Shkupit dhe kryeqendrave të tjera të vendit tonë. Gjithashtu do t'i realizoj planet e udhëtimeve studiuese jashtë vendit në Paris, Itali e gjetiu.

— Dëshira juaj?

— Dëshiroj që arti figurativ të depërtojë thellë në masa të gjera dhe shoqëria të ketë mirëkuptim më të madh se sa gjer më tani...

H. HASANRAMAJ

JETA KULTURALE 21-8-74

NGA KOLONIA E PIKTORËVE TË KOSOVËS NË DEÇAN

# FRYMËZIME NË HIJEN E PISHAVE

■ **Piktorët nga vendi e bota e jashtme po pushojnë dhe krijojnë në qendrën tonë më të madhe turistike**

■ **Vizita e ekspozita të punimeve në Deçan e rrethinë**

**Deçani pitoresk me pishat e veta qindvjeçare, ajrin e pastër, Bistricën e ftohtë si lëngu i borës, me ujin e thartë dhe bukuritë e tjera është vend i dashur, përveç për shumë mysafirë, edhe për piktorët dhe shkrimtaret nga Kosova, vendit dhe bota e jashtme, të cilët për çdo vit në muajin gusht në këtë vend pushojnë dhe punojnë.**



Deçani — vend takimi e pune për piktorët

Për t'u informuar për punën e pikëtorëve i vizituam dhe biseduam me ta. Si na njohtoi udhëheqësi i Kolonisë së pikëtorëve, Nimon Lokaj, si zakonisht edhe sivjet piktorët do të qëndrojnë në Deçan 10 ditë. Qëllimi i Kolonisë së piktorëve është reaktiv, shkëmbim bisedash, me ndimesh e përvojash.

— Në punën e sivjeme të Kolonisë së piktorëve po marrin pjesë 12 piktorë nga Kosova, Zagrebi Lublana, e Beogradi, a mysafir nga bota e jashtme është piktor nga Bashkimi Sovjetik.

Piktorët po punojnë në teknika të ndryshme figurative dhe çdo njeri prej tyre në përfundim të punës së kolonisë është i obliguar që kolonisë t'i dhurojë një vepër pikturale ose në teknika të tjera figurative. Materialet për përpunimin e veprave artistike figurative piktorëve të kolonisë u jep Bashkësia Krahinore e kulturës. Kështu, me vepra pikturale të Kolonisë së Deçanit po pasurohet mirë fondi i veprave figurative të një galerie të ardhshme të Kolonisë së Deçanit.

Piktorët e Kolonisë së Deçanit gjatë këtyre ditëve do të hapin një ekspozitë në lokalet e hotelit „Visoki Deçani", ku do të paraqiten me punimet e tyre artistike figurative.

Ekspozita të tilla do të hapen edhe në Pejë, Prishtinë dhe në qytete të tjera të Kosovës.

Problem, i cili është duke e penguar punën normale të Kolonisë së piktorëve në Deçan, është mungesa e një lokali ku do të punonin dhe pushonin piktorët. Për këtë çështje për çdo vit po bëhet fjalë, por në këtë qendër turistike, ku për çdo vit takohen piktorët kosovarë e mysafirë nga vendi dhe bota, nuk ekziston një lokal i caktuar për argëtim dhe pushim të mysafirëve, megjithëse për këtë qëllim do të mund të shfrytëzoheshin shtëpia e kulturës e shtëpia e rinisë apo ndonjë lokal tjetër i përshtatshëm. Por, piktorët shpresojnë së në vitet e ardhshme do të ketë mundësi më të mira që të zgjidhet edhe ky problem.

Në fund të bisedës, Nimon Lokaj na informoi se piktorët gjatë qëndrimit në Deçan do t'i vizitojnë fshatrat më karakteristike dhe atje drejt për së drejti do t'i shprehin përshtypjet e tyre në veprat e tyre figurative...

H. HASANRAMAJ

GALERIA E VOGËL

# STATIKA DHE RITMI

Piktori akademik Nimon Lokaj pikturoi pejsazhin e blertë, të ambientit ku jeton dhe krijon, në raporte koloristike intenzive, me ndjesi për pikturimin impresiv poentilik të kurorave të drunjëve të drejtë e vërtikalë. Lokaj kompozoi veprën pikturale duke ndarë hapësirën në dy pjesë baraspeshuese, duke kompozuar drurin e bardhë në këndin e djathtë, në bazë të parimit të ashtuquajtur «Prerja e art», dhe duke pikturuar kurorat e drunjëve të blert në pjesën e epërme në raport ritmik me njëri tjetrin. Ndaj, piktori, duke u nisur nga koncepcioni i qart ideoestetik dhe duke vënë në pejsazhin e blertë drurin e bardhë në qendrim vërtikal, simbolikisht sugjeroi të mirën e njeriut, që artistët e përjetësuan në veprat artistike. Vepra e tij «Nën pishat e Deçanit» nuk është kopjim i natyrës objektive, por më parë transponim dhe krijim artistik i vizionit interesant asociativ – simoblik, i cili, duke shquar vërtikalën dhe horizontalën «flet» për kundërthënjet dialektike të zhvillimit të njeriut dhe të natyrës. Ideja e tij, pra, e konceptuar si statikë dhe levizje, si vërtikale dhe horizontale, prekë sfera të ndjeshme të natyrës së njeriut, i cili nëpër kohë përmes artit u përpoq ta humanizojë dhe fisnikërojë botën njerëzore. Në këtë vepër verehet intervenimi i piktorit, i cili ndjen intuitivisht të tepërtën e natyrës objektive dhe duke ia shtuar asaj të domosdoshmën e bukurisë estetike, krijoi botën pikturale vërtet subtile dhe mjaft autentike, me reflekse të një lloj poentilizmi bashkëkohor, nëse mund ta quajm kështu. Piktori, duke shfrytëzuar përvojën e krijuesve të mëdhenj të pikturës, shquan qenësorën e frymës bashkëkohëse estetike. Vepra e Lokës «Nën pishat e Deçanit» është krijim



i studjuar me përkushtim dhe mjaft atmosferë pikturale. Hapësira e poshtme-e qetë, dhe hapësira e epërme – ritmike krijojnë levizjën dhe statikën interesante, duke eliminuar nga kompozimi gjithëatë që është e tepërt dhe duke shquar atë që synon ta shprehë krijuesi bashkëkohës.

Nebih MURIQI

E shtunë, 16.V1981 15

## ● «Pishat e Deçanit» e Nimon Lokajt

Në krijimtarinë e pikturës kosovare, njeri ndër piktorët më të frytshëm është edhe Nimon Lokaj. Inspirimi i tij për trajtimin e pishave të Deçanit në pikturë është i kahmotshëm. Me këtë inspirim piktori ka realizuar një sërë pikturash në ciklin e tij «Pishat e Deçanit», i cili, si shihet nga prezentimet e autorit, ende vazhdon. Duke lënë anash temën, orientimi i këtij krijuesi konsiston në mënyrën poentilike të të pikturuarit. Sikurse edhe te poentilistët e parë, edhe në «Pishat e Deçanit», pikat e hedhura nuk varirojnë. Ato gjithashtu edhe vizuelisht qëndrojnë aty ku janë vendosur. Edhe në reproduksionin tonë, që është njëra nga pikturat e ciklit të përmendur, zotron fund e krye mënyra e realizimit e përmendur me parë.

Sikurse në tërë ciklin, kështu edhe në pikturën «Pishat e Deçanit», hapsira më e madhe krijohet në mes të trungjeve apo trupave të pishës. Është karakteristike vija e drejtë dhe sfera. Krahas shtyllave, që në këtë rast paraqesin trupat e pishave, edhe sferat janë elemente asociative. Ato herë plotësojnë pjesën e epërme të pikturës, që lënë impresionin herë të kupave e herë të kupolave, e herë përmbushin pjesën e poshtme të saj, ku paraqitet turma e gjerë e figurave, me kokat e sferat e tyre. Kështu, prej sferave e gjysëmferave të mëdha dhe atyre më të vogla bëhet një kapërcim i lehtë e gradual. Autori nën sfera fsheh shumë forma, si të njeriut ashtu edhe të



«Pishat e Deçanit»

pejsazhit, me të cilat hetohet synimi kah një transformim i përgjithsuar i elementeve.

Toni qensor koloristik edhe në këtë pikturë si edhe në pjesën dërmuese të ciklit mbetet e gjelbërta me thekse jo të imponueshme të së kuqes, të së kaltërtës dhe të ngjyr–vjollcës.

V. NURA

E premte, 8.III.1985

# PIKTORI QË SHIKON BOTËN NËN DYLPITË E KOHËS

PIKTORI QË ME VEPRËN E VETË TË BIND se ka një botë të afërt dhe magjike. Ngërthen në vete një kolorit të kohës në të cilën lind dhe krijohet. Përjetime të idhta pelim. Kemi kë-



„HAPSIRE URIJE" (TUSH)

tu një qasje interesante — qasje t'asaj që e mundon shpirtin e çdo njeriu në jetë.

Laramania që ngërthen puhia lirike e pikturave të Nimon Lokajt, na bëjnë për veti që në momentin e kontaktit të parë me pikturat e këtij talenti, që jo vetëm që na premton një krijimtari të frytshme, por edhe të ndërduarshme dhe tejet interesante përkah mënyra e përpunimit të ideve pikturale. Ngjyrë që është (në këtë apo atë mënyrë) origjinale. Krejt kësaj duhet t'i shtojmë emër të bukur dhe magjeps që mund të jetë i afërt për ne. Të jetë ajo çka jemi ne.

Atë që bën Lokaj në pikturë është diç që me ngrohtësinë e shprehjes të jep drithërim të butë ndjenje dhe kacafytjeje me qenjen tënde të bën të kuptosh se është diç nga ajo, që edhe ti mbërthen në vete . . .

„Gallaksioni", „Nën kapelën e vdekjes", „Dylpitë", „Ca figura", „Hapësirëlirie", Stuhia" etj., janë vepra që vulosin një periudhë të caktuar në krijimtarinë e këtij autori që premton një botë madhështore, të thërret ta shikosh, përjetosh, të mbetesh ca momente prezent në kohën dhe botën e tij.

Piktori dhe kapela e vdekjes. Vulë kjo që s'i heqet nga koka tërë jetës. Diç. Jetë. Çfare? Asofare, në kohën kur lindi piktori.



„STUHIA" (TUSH)



„NEN KAPELEN E VDEKJES"

Ja dhe prezenca e një gjithësie. Gallaksioni. Një jetë e shndërruar në gallaksion. Aty ka mister. Ka botë: jo — botë. Për ne anatemë. Jetë që vlon në sfingat kosmike. Jetë gallaksionesh.

Dhe filloi të ngarend koha. Ngarendja e saj la vrragë pas vetes. Shkoi. Por nuk shkoi kujtimi. Ai zhbiroi çdo pore tonën. Këtu lindi një kohë. Një kohë në hapësirë të përmotshme. Hapësirë që do të mbetet edhe pas nesh, ishte dhe para nesh. Mesmedium. Një kohë lindi e emëruar. Ajo emërohet Noman Lokaj.

Qerim ARIFI



ART FIGURATIV

# ATMOSFERË FLUIDE E ARTISTIT

Kur i ke pranë pikturat e NIMAN LOKAJT, që tashmë është bërë emër i njohur në pikturën kosovare, pa mëdyshje se të kujtohet ambienti në të cilin ai krijon dhe nga i merr frymëzimet e tij për veprat. Kur para disa ditësh e hapi ekspozitën e tij në Galerinë e Portretit Jugosllav në Tuzëll, kjo ekspozitë zgjoi interesim të madh te këta artadashës. Në atë ekspozitë personale, që ka karakter federativ, punimet e tij Lokaj i ka sistemuar në tri cikle: i pari «Sinteza e peizazhit Deçanas», i dyti «Akuarelet 1978-1980» dhe i treti «Lirinë athua na e fali kush».

Veprat për këtë ekspozitë u bënë sipas zgjedhjes së autorit, kështu kemi pasur rast që të ndeshemi me një vistër punimesh të këtij piktori me të cilat është bërë individualitet krijues me kreativitet dhe tonalitete individuale që përshkohen nga tone ngjyrash të vendit, i cili është me të vërtetë i bukur dhe plot jetë bukolike e magjepse.

Sipas afinitetit të tij ai zgjedh për motive pyjet me pisha, që janë pamje mbizotëruese të Deçanit. Nëse mund të themi se peizazhi është formë e njohur, mu në veprat e tij nuk e kemi këtë poentë dhe për këtë arsye e ndeshim peizazhin të reduktuar, herëherë të prirur edhe për pamje që janë të njohura, dhe të dashura.

Në akuarele ndeshim një plasticitet tejet të bukur dhe mjaft të lehtë të autorit, që në format e shumta të këtyre anëve bën shprehje poetike në veprën e tij.

Ritmi dhe harmonia e veritikaleve në tonalitetin e tyre plot bokolikë sikur dëshirojnë ta arrijnë fluiditetin e tij të madh drejt atmosferës dhe ambientit.

Në ciklin e tretë Lokaj është vizionar i botës në të cilën jeton dhe për të cilin mediton dendur. Tërë peripetitë e mundshme të asaj që ndodhin dhe mund të ndodhin në hapërimin bashkëkohor të njeriut drejt rrugës së tij në shekullin e ri, Lokaj na i jep me parafytyrimet e tij optimizmin e madh se njerëzimi ka filluar ta kuptojë vlerën e ekzistimit të tij në planet.

Në këto punime ndeshim edhe tema patriotike nga e kaluara e lavdishme e Luftës Nacionalçlirimtare: Sutjeska dhe shumë tablo të tjera që janë mishëruar me qenien e njerëzve tanë që luftuan për liri, përveç vlerës së lartë artistike, kanë edhe notën e tyre edukative socialiste që mbillet parreshtur prej brezi në brez në vendin tonë.

Lokaj në të gjitha këto punimet ka diçka të veten individuale dhe, ajo që është më me rëndësi, thellësisht njerëzore të ngritur mbi piedestalin e trashëguar të brezave që na i lanë amanet lirinë, bukuria e së cilës është dashuria jonë.

Qerim ARIFI



Niman Lokaj: «Lirinë athua na e fali kush» (vizatim)

11



Nimon Lokaj
*Peizazh*, 1973
Akuarel
10 × 42 cm



Nimon Lokaj
*Pishat e Deçanit*, 1976
Vaj në pëlhurë
102×102 cm



Nimon Lokaj
*Pishat e Deçanit*, 1977
Vaj në pëlhurë
102×102 cm



Nimon Lokaj
*Pishat e Deçanit*, 1977
Vaj në pëlhurë
102×102 cm



Nimon Lokaj
*Pishat e Deçanit*, (p.d.)
Vaj në pëlhurë
70×80 cm

Violeta Xhaferi





RILINDJA

NGA SHOQATA E ARTISTËVE APLIKATIVË TË KOSOVËS

# PUNË E FRYTSHME NJËVJEÇARE

## ●Kryetar i ri u zgjodh Violeta Xhaferi

Parmbrëmë, në lokalet e Galerisë së Arteve të Kosovës u mbajt mbledhja vjetore e Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës. Kuvendin e hapi ish – kryetari i Shoqatës Engjëll Berisha. Ai me këtë rast i njohtoi të pranishmit për punën njëvjeçare të këtij asociacioni si dhe për raportin financiar. Gjatë periudhës njëvjeçare SHAAK ka arritur të realizojë një sërë aktivitetesh, ndër të cilat edhe ekspozitat e rëndomta si dhe ato të cilat janë organizuar për herë të parë. Ndër ekspozitat ai përmendi «Plakatin kosovar» si dhe «Sallonin e karikaturës» të cilat janë organizuar për herë të parë dhe të cilat janë me mjaft interes. Për këto dy ekspozita të pranishmit ishin të mendimit që ato tash e tutje të marrin karakter tradicional. Në të ardhshmen siç u tha duhej të ndaheshin mjete që dy apo tri plakete më të mira të realizohen në shtyp. Për këtë do të duhej të bashkëpunohej me gazetën «Rilindja» si dhe me revistat tona të tjera.

Deri në fund të këtij viti këtij asociacioni i kanë mbetur mjaft mjete, nga këto gati gjysma është arritur të kursehet. Prandaj u bë fjalë edhe për mundësitë e shfrytëzimit të tyre.

Me këtë rast u bë edhe zgjedhja e organeve të Shoqatës. Kështu kryetar me mandat njëvjeçar u zgjodh Violeta Xhaferi, ndërkaq sekretar Rexhep Goqi. Për të shënuar punën dhjetëvjeçare të SHAAK u nxorr informatori i cili me këtë rast iu dha anëtarëve të pranishëm. Në këtë informator janë përmbledhur shkurtazi të gjitha ekspozitat kolektive e personale, që janë ilustruar edhe me reproduksione, pastaj janë shënuar shpërblimet si dhe ligjëratat, udhëtimet e studimit, simpoziumet dhe kongreset e mbajtura në vend dhe në botë. Veç kësaj në këtë informator, i cili ka të dhëna mjaft të përgjithësuara e të përmbledhura, është shënuar edhe pranimi i anëtarëve të rinj gjatë pesë vjetëve, kryetarët e gjertanishëm si dhe është dhënë njëfarë dokumentacioni për shkrimet e ndryshme të ekspozitave që kanë të bëjnë në një mënyrë apo në një tjetër me krijimtarinë artistike të kësaj Shoqate.

V.N.

E premte, 1.VII.1983



TAKIMI I SË SHTUNËS

# PËR KONCEPTE TË REJA TË ROLIT TË KRIJUESIT NË PRODHIMTARI

**● Bisedë me Violeta Xhaferin, autoren e shpërblimit të parë në Sallonin XI Pranveror të Arteve Figurative dhe Aplikative të Kosovës '84**

Violeta Xhaferi, kostumografe në Teatrin Popullor Krahinor, për Sallonin e Sivjetshëm fitoi shpërblimin e parë për realizimin «Ana Karenina». Kjo krijuese aplikative para bukur do vjetësh, e para ndër ne, kreu akademinë e Arteve Aplikative, grupin e kostumit skenik dhe bashkëkohor, në Beograd. Në punën e saj dymbëdhjetëvjeçare realizoi shumë kostume të shfaqjeve teatrore e ato të filmit, pastaj punoi në sipërmarrjet prodhuese si kreatore e modës, në Kombinatin e Lëkurë-këpucëve të Pejës dhe në sipërmarrjen e artizanatit «Kosovarja» në Prishtinë. Nga shpërblimet më me rëndësi të autores, përmendim Shpërblimin e Dhjetorit, shpërblimin për kreacion në ekspozitën e Inovacioneve, shpërblimin e SHAAK '76 etj.

**● Shpërblimi i parë i Sallonit të sivjetshëm iu nda një krijuesi nga lëmi i arteve aplikative. Çdo të thotë kjo?**

– Është hera e parë pas dhjetë vjetësh pune të Sallonit që në të të ekspozohen edhe veprat e artistëve aplikativë. Është me rëndësi të theksohet se të gjitha veprat e ekspozuara i kanë plotësuar kërkesat e seleksionuesit, që do të thotë se në vehte kanë ngërthyer të gjitha ato aspekte që e ndërtojnë një vepër artistike, qoftë kur është fjala për vepra që i takojnë lëmit të arteve aplikative. Sëkëndejmi del i pambështetur distinkcioni herë-herë i ngarkuar me vlerësime jokritike zhvlerësuese në dëm të njërës apo tjetrës degë. Fundja, të gjitha ato janë krijime po që se në vete integrojnë ato aspekte, që e cilësojnë veprën artistike. Edhe punimet e mia, do të thosha se në vete mpleksin këto kërkesa, e veçmas ekzekutimin figurativ të idesë.

**● Artet aplikative këtu në Kosovë ende nuk po mund të emancipohen sikur ato figurative? Ç'mendoni ju për këtë?**

– Keni të drejtë. Derisa në mjedise të tjera, nën ndikimin dhe kërkesat e industrisë, artet aplikative kanë marrë hov, te ne në Kosovë ato kanë mbetur në fazën embrionale, përkundër ekzistimit të kuadrove të afirmuara në vend, si Matej Rodiqi, Shyqri Nimani, Agush Beqiri etj. Krahas mungesës së industri- dhe kërkesës, edhe mosrespektimi, moskuptimi i specifikës së punës së artistit aplikativ, ndikon në atrofimin e këtyre degëve. Prandaj, ata kërkojnë prehje në krijimtarinë figurative.

**● Ju jeni nga të rrallët, që keni punuar edhe në prodhimtari?**

– Po, në Kombinatin e Lëkurë-Këpucëve të Pejës dhe në ndërmarrjen e artizanatit «Kosovarja» në Prishtinë. Kjo ishte për mua një sfidë e

Violeta Xhaferi

madhe, sepse gjithmonë kam dëshiruar t'i konkretizoj idetë. Prandaj, pas katër vjet pune në TPK e lash atë për t'u inkuadruar si kratore e prodhimeve industriale. Në fillim bashkëpunimi ishte mjaft i vështirë, pak për shkak të paragjykimeve të trashëguara për femrën, pak për shkak të koncepteve të tyre anakronike për punën. Çdo kërkesë për inovacion pritej me habi, nga që vështirë hiqnin dorë nga ecuria, që nuk peshonte me kërkesat e kohës, apo me një indiferencë i qaseshin punës. Ndodhte, për shembull, që pa mbikqyrjen time të viheshin pulla a ndonjë detaj tjetër, që nuk i përgjigjej aspak modelit të paraparë. Kështu, në fazën e parë, krijuesi shëndrrohet në demonstrator, pastaj në punëtor fizik, që vrapon nga reparti në repart, që lut, që nxit, që kontrollon çdo gjë. Në mbarim të kësaj ecejakjeje kupton se nuk të ka mbetur fare kohë për punë kreative. Me këtë përvojë për vështirësitë dhe të papriturat e procesit prodhues, iu përvesha punës për themelimin e sipërmarrjes së artizanatit «Kosovar- [...] dër dizajni, ku përmes intervenimit artistik prodhimet e folklorit tonë të pasur do të transponoheshin në artikuj të konsumit. Por, nuk ia dola dot, kryesisht për shkak të mungesës së ekipit profesional dhe koncepteve të reja për rolin e krijuesit në prodhim. Kjo ndikoi që «Kosovarja» të shëndërrohet në sipërmarrje tregëtare dhe gradualisht ta ndërrojë fizionominë. Këtë e dëshmon deridiku shitorja «ekskluzive» ose më mirë të themi «komisioni» i kësaj organizate te Hotel Grandi, ku shitet çdo gjë: porcelani kinez, shamia nga india, shporta kashte, çanta të lëkurës së krokodilit e më së paku, prodhime të trevës sonë. Të gjitha këto, moskuptimi, mosrespektimi i punës së krijuesit, mungesa e punës ekipore, indiferenca ndikojnë që krijuesi t'i ikë prodhimtarisë. Ndërkaq, në sipërmarrjet e tjera të vendit, me marrëdhënie më të avancuara prodhuese punojnë nga 3,4,5, krijues të specializuar, te ne del se është i tepërt edhe njëri. Prandaj vendosa që t'i kushtohem punës kreative joprodhuese.

**● Si kryetare e Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës, a mund të na thoni diçka për planet e këtij asociacioni?**

– Ndër planet më ambicioze të Shoqatës për vitin 1984 nuk do mend se është organizimi i ekspozitës në fund të muajit shtator «Transponimi i folklorit në prodhimtari», që do të ketë për qëllim ruajtjen e traditave popullore në saje të revitalizimit të tyre, inkuadrimit funksional në jetën bashkëkohore. Kjo, jo vetëm që do të kishte efekte etnografike, por edhe ekonomike, nga që do të jepte një shtytje degëzimit të ekonomisë së vogël, e krahas kësaj, do të fisnikëronte edhe ambientin jetësor. Kjo ekspozitë do të hapë horizonte të reja në zhvillimin e mëtejmë të arteve aplikative, duke u dhënë një funksion real, konkret shoqëror, sidomos atyre degëve që përkundër traditës së zhvilluar kanë ngecur prapa tendencave të reja, si qeramika, druri, tekstili e deridiku edhe tapiceria. Artikujt që do të ekspozoheshin (qeramikë, tapiceri, kostum, pjesë mobiljesh etj) nuk do të jenë vetëm produkte të artistëve por edhe të zejtarëve, që do ta sendërtonin idetë e krijuesit. Me këtë në mënyrë të organizuar do të fillohej krijimi i punkteve të specializuara të zejtarëve nëpër fshatra e qytete, që dukshëm do ta përmirësonin standardin e tyre jetësor.

E shtunë, 19. V. 1984

RILINDJA



Violeta Xhaferi:
Udhëtim artistik nëpër kohë

Violeta (Zariqi) Xhaferi e lindur më 1947 është kostumografe, piktore edhe grafiste. Një ndër artistet e para kosovare të edukuara formalisht, Xhaferi ka pasë një karrierë të bujshme duke zhvilluar një praktikë të gjerë që mbulon kostumografinë për teatër e film, pikturën, dhe së fundi instalacione me kanavacë. Pasi që kreu studimet në Kostumografi në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd në vitin 1972, Xhaferi punoi si kostumografe në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Gjatë viteve të '90-ta ajo emigroi në Norvegji ku filloi të eksperimentonte me pikturë, qelq dhe grafikë. Ndonëse Xhaferi mori pjesë në shumë ekspozita kolektive dhe ishte pjesë integrale e skenës së artit modern të Kosovës që nga vitet e '70-ta, ajo hapi ekspozitën e saj të parë personale vetëm në vitin 2003 në Prishtinë dhe Tiranë. 20 vite më vonë, shumë nga këto punime u shfaqën krahas punimeve të saja më të reja në kanavacë si pjesë e retrospektivës "Rishikime," të kuruar nga Hana Halilaj në Galerinë Kombëtare të Kosovës.

Gjatë dy bisedave të mbajtura me Xhaferin përmes telefonit derisa ajo ishte në Kristiansand, Norvegji, në fund të tetorit dhe fillim të nëntorit 2023, ajo theksoi se punën e saj e shtyen një kureshtje e pandalshme për të eksperimentuar dhe për të krijuar art të angazhuar politikisht.

"Ka njerëz që artin e konsiderojnë vetëm si diçka të bukur, diçka që s'duhet të angazhohet me atë çka ndodhë, diçka më abstrakte, më minimaliste—sidomos në Norvegji është ashtu," thotë Xhaferi duke iu referuar shtetit ku jeton që nga vitet e '90-ta kur u zhvendos me fëmijët e saj për shkak të situatës politike në Kosovë. "Jam krenare që nuk i takoj grupit të artistëve që merren veç me minimalizëm, po jam piktore që kam qejf me qenë në ngjarje, e kyçur me atë se çka ndodhë në botë."

Pikturat më të famshme të Xhaferit janë një seri e shfaqur së fundi sërish në Prishtinë: me ngjyra pastel që përkujtojnë kryeveprat e pop artit botëror, Xhaferi sjell një seri pikturash me figura dhe imazhe që shihen nëpër ekranet tona televizive për të problematizuar ngopjen dhe desensibilizimin e qytetarëve. Këto

piktura Xhaferi i kishte realizuar në Norvegji në fund të viteve të ‘90-ta derisa e shikonte në televizion rënien e Jugosllavisë dhe dhunën që po ushtrohej në vendlindjen e saj në Kosovë.

Rruga për tek piktura për Xhaferin ishte e tërthortë, ndonëse e kishte pasë pasion gjatë tërë jetës së saj. Xhaferi e filloi karrierën e saj në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Artit në Prishtinë, ku dashurinë për pikturë ia kishte ushqyer profesori Gjelosh Gjokaj. Ndonëse, Xhaferi kishte dashur të vazhdonte të studionte pikturën në Akademinë e Arteve në Beograd, Teatri i Kosovës, i cili kishte nevojë urgjente për kostumograf, i kishte ofruar bursë për të studiuar kostumografinë tek Akademia e Arteve Aplikative. Vitet në Beograd ishin transformuese për Xhaferin, jo vetëm në aspektin akademik por edhe në zgjerimin e perspektivave të saj mbi artin dhe politikën. Akademia e Arteve Aplikative ishte e para në rajon, dhe kështu Xhaferi pati mundësine të njoftohej me artistë nga tërë Evropa juglindore.

Duke i kujtuar vitet studentore, Xhaferi mban mend vështirësitë në hulumtim i cili duhej të bëhej në bibliotekën e qytetit dhe në Muzeun e Artit Bashkëkohor. Megjithatë me dashamirësi mban mend edhe që kishte qenë mu në Beograd ku për herë të parë kishte parë punimet e pop artistëve të ndryshëm.

Pas përfundimit të studimeve Xhaferi kthehet në Prishtinë ku punoi me vite të tëra si kostumografe në atëkohë të ashtuquajturin Teatrin Krahinor. Në Koleksionin e Galerisë, ende ruhen në fond vizatimet e saja të kostumografisë së Ana Kareninës dhe Ofelisë. Ndonëse në të njëjtën kohë, Xhaferi kishte filluar të krijonte familje me burrin e saj, politikanin e njohur shqiptar Arbën Xhaferi, përgjatë gjithë kohës kishte qenë një nga gratë e ralla artiste aktive në skenën e artit. Në Sallone të ndryshme që përfshinin artin aplikativ, Xhaferi ishte paraqitur me vizatimet e saja për kostumografi.

“Në një periudhë, kam qenë e vetmja femër që ka marrë pjesë në ekspozita kolektive me kolegë artistë,” tregon ajo. “Por për fat të mirë arti nuk ka gjini apo jo? Kur e sheh një vepër të artit nuk mundesh me ditë se autori a është femër apo mashkull,” thotë ajo me përplot bindje.

Teatri nuk ishte hapësira e vetme ku Xhaferi pati mundësinë për të luajtur me tekstile dhe modë. Në vitet e ‘70-ta Xhaferi kishte punuar edhe për Fabrikën e Lëkurës në Pejë, ku



përkundër rezistencës së punëtorëve për ta pranuar një grua të re e të edukuar si disenjatore të modeleve, Xhaferi kishte arritur të modelonte dhe realizonte një revy mode në Hotel Jugosllavia në Beograd. Më vonë gjatë viteve të ‘80ta, Xhaferi kishte punuar edhe me shoqata artizanale të grave, duke eksperimentuar me pëlhura e teknika, siç është veku. Në vitin 1981, Xhaferi kishte organizuar një revy të dytë mode në Hotelin Grand në Prishtinë, që ishte mbuluar nga revista të mëdha mode në Jugosllavi si revista kroate Svijet dhe Bazaar.

Gjatë kësaj periudhe, që shënohet nga ashpërsimi i represionit politik në Kosovë, Xhaferit iu desht të tërhiqej nga aktivitetet e saja të shumta.

Rikthimi i saj në pikturë më vonë në jetë nuk ishte vetëm një ringjallje e një pasioni të mëparshëm por edhe gjetja e formave të reja për të qenë më e angazhuar me ngjarjet në botë.

Nga seria pikturave të saja të punuar në fundin e viteve të ‘90-ta dhe në fillim të viteve 2000, Xhaferi eksploron temat e luftës, zhvendosjen dhe qëndrueshmërinë e njerëzve. Në vitin 2022, një nga këto piktura, e titulluar “Kur sosën fjalët” u ble nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për t’iu shtuar Koleksionit të GKK-së. Në këtë pikturë, Xhaferi luan me kompozicion duke paraqitur në një anë një grumbull politikanë, në anën tjetër një grumbull ushtarësh, dhe në pjesën qëndrore të veprës, dy figura të fëmijëve duke qarë. E pyetur mbi kuptimin e veprës, Xhaferi meditoi mbi figurën e përsëritur të ushtarëve në veprat e saja duke shtuar se në filozofinë e saj këto vepra e kapin esencën e luftës.

“Çdo luftë i ka tre subjekte: është politikani, ushtari dhe viktima. Politikani flet, ushtari vepron, viktima vdes,” thotë Xhaferi. “Unë besoj se kjo pikturë e imja është universale, mund të shkojë kudo dhe është gjithnjë aktuale. Ja për shembull tani kemi luftë mes Palestinës dhe Izraelit—në këtë luftë po ashtu më së shumti pëson fëmiu. Do të thotë, kur sosen fjalët, mos pyet! Atëherë ndodhin tragjeditë e mëdha.”

Violeta Xhaferi
*Ofelia I*, 1983
Teknikë e kombinuar
100 × 70 cm



Violeta Xhaferi
*Ana Karenina*, 1984
Teknikë e kombinuar
92 × 63 cm



Violeta Xhaferi
*Kostume Kombëtare nga Shqipëria*, 1975
Teknikë e kombinuar
45 × 68 cm





Violeta Xhaferi
*Kostumet e shekullit XIV*, 1986
Teknikë e kombinuar
100 × 70 cm

Violeta Xhaferi
*Kostume Gotike*, 1986
Teknikë e kombinuar
100 × 70 cm





Violeta Xhaferi
*Kur sosën fjalët*, Diptik, 1994
Akrilik dhe vaj në pëlhurë
180 × 140 cm (të dyja)

*Tregime pas / Tregime nëpër*
*Koleksionin e Galerisë Kombëtare të Kosovës*

Hulumtimi:
Rina Krasniqi, Simon Kurti

Redaktimi:
Lura Limani

Tekstet dhe intervistat:
Rina Krasniqi
Simon Kurti
Lura Limani

Dizajni:
Bardhi Haliti

Fotografitë:
Enver Bylykbashi

Botuar nga:
Galeria Kombëtare e Kosovës

Print / Shtypi:
Shtypshkronja Blendi

ISBN 978-9951-806-27-5

Gusht, 2024
Prishtinë

Stafi i Galerisë Kombëtare të Kosovës:

Alisa Gojani Berisha, *U.D. Drejtoreshë*, Hana Halilaj, *Kuratore*, Naim Spahiu, *Koordinator i Ekspozitave*, Skender Xhukolli, *Teknik i Ekspozitave*, Enver Bylykbashi, *Fotograf*, Engjëll Berisha, *Koordinator për marrëdhënie ndërkombëtare*, Vlora Hajdini Hajrullahu, *Koordinatore për Edukim, Hulumtim dhe Publikim*, Shkamb Jaka, *Koordinator për Media dhe Marrëdhënie me Publikun*, Mexhide Maxhuni, *Financiere*, Elsa Morina, *Zyrtare Administrative*, Majlinda Zogaj, *Zyrtare Ligjore*, Xhevat Rrahmani, *Kujdestar i Sallës Ekspozuese*, Valdet Syla & Mentor Abdullahu, *Roje Nate*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*
*Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta*
*Ministry of Culture, Youth and Sport*

JETA KULTURALE 21-8-74

NGA KOLONIA E PIKTORËVE TË KOSOVËS NË DEÇAN

**FRYMËZIME NË HIJEN E PISHAVE**

- Piktorët nga vendi e bota e jashtme po pushojnë dhe krijojnë në qendrën tonë më të madhe turistike
- Vizita e ekspozita të punimeve në Deçan e rrethinë

NË ATELEUN E NIMAN LOKAJT

**„FATI NË TREKËNDSH"**

EKSPOZITA

**FIGURA SI PREOKUPIM MË I GJERË**

- Me rastin e hapjes së ekspozitës së SHAFK « 25 vjet të Shoqatës së Artistëve figurativë të Kosovës» në Galerinë e Arteve të Kosovës

NGA SHOQATA E ARTISTËVE APLIKATIVË TË KOSOVËS

# PUNË E FRYTSHME NJËVJEÇARE

● Kryetar i ri u zgjodh Violeta Xhaferi

# *PIKTORI QË SHIKON BOTËN NËN DYLPITË E KOHËS*

# E GJELBËR ËSHTË BUKU-RIA NË GURË